

**UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИБЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY**

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИБЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI DYTË

TEMA MASTER

FIGURA E FEMRËS NË VEPRAT E HELENA KADARESË


Kandidatja:

Fitore Jahiji

Mentori:

Prof.dr Hamit Xhaferi

Tetovë, 2020



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEMA MASTER

FIGURA E FEMRËS NË VEPRAT E HELENA KADARESË

Kandidatja:

Fitore Jahiji

Mentori:

Prof.dr Hamit Xhaferi

Tetovë, 2020

Deklaratë mbi origjinalitetin e temës së masterit: Figura e femrës në veprat e Helena Kadaresë

Ky punim i temës së masterit paraqet punën time origjinale. Andaj punimi si i tillë nuk përmban, sipas mendimit tim asnjë material të botuar ose të shkruar nga ndonjë individ tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi

D a t a

Fitore Jahiji

HELENA KADARE

Kohë e pamjaftueshme

KUJTIME



Pena e saj mbetet universale për çdo kohë dhe çdo sistem...

Falënderime

Një falënderim të sinqertë ia kushtoj udhëheqësit tim shkencor, Prof. dr. **Hamit Xhaferi**, për përkrahjen dhe mbështetjen e tij morale dhe profesionale, veçanërisht për këshillat e vyera dhe gatishmërinë e tij i cili e ka ndjekur këtë studim të magjistraturës hap pas hapi, duke më mbështetur për risitë që përcillte, por njëkohësisht duke më dhënë sygjërimet e tij profesionale mjaft të vlefshme duke synuar tek unë ngritjen e nivelit shkencor dhe letrar të këtij punimi të masterit.

Një mirënjohje e veçantë ua dedikoj edhe prindërve të mij, të cilët më kanë mundësuar realizimin e këtij studimi, duke më mbështetur me gatishmërinë e tyre në përgatitjen time serioze gjatë mësimdhënies. Andaj ky punim nuk do të mundësohej pa mbështetjen e jashtëzakonshme të mentorit tim dhe familjes sime.

A b s t r a k t

Arsyeja pse kam vendosur që pikërisht nga lënda e letërsisë së sotme shqipe të zgjedh temën e magjistraturës, ka qenë e thjeshtë, sepse çdo herë më kanë pëlqyer veprat e **Helena Kadaresë**, posaçërisht figura e femrës dhe roli që luan kjo në veprat e kësaj krijuesje, e në veçanti rëndësia dhe pesha e saj në jetën e përditshme. Kjo më është dukur mjaft tërheqëse sa për të qenë e vendosur që t'i hyj kësaj pune me përgjegjësi morale dhe profesionale. Qëllimi im për këtë temë të masterit ka qenë që njohuritë e fituara në fakultet, t'i thelloj edhe mëtej duke i paraqitur në formë të punimit të thelluar të magjistraturës. Prandaj qëllimi i punimit është që të jetë i kuptueshëm për lexuesit, që ata të mund të bëjnë krahasime mes femrës dhe rolit që luan ajo në romanet e **Helena Kadaresë**. Duke më ndihmuar në masë të madhe romanet e kësaj autoreje si burime me të dhëna më të sigurta, si dhe nga materialet tjera në portale të ndryshme, arrita të përmbledh disa nga elementet kryesore që duhet të theksohen në temën e këtij punimi.

Besoj të kem arritur që, sado pak, në një masë modeste të përfshij pikat kryesore që lidhen me rolin që luan femra në romanet e **Helena Kadare**, që çdokush që e lexon ta kuptojë thelbin e tyre, e me këtë të arrij dhe unë qëllimin tim rreth këtij punimi. Si fjalë e parë, jam shumë e lumtur që kam arritur në këtë pikë të studimeve dhe të kem rastin të punoj me vullnet tezën e magjistraturës, me të cilin edhe formalisht do të shënoj përfundimin e studimeve të mia në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

The reason why I have chosen today's Albanian literature as my master thesis is simple, it is because I have always enjoyed the works of **Isa Kadare**, especially the women's image and the role she has in the works of this writer, and in particular her importance and significance in everyday life. This seemed to me quite attractive as to be determined to get into such work with moral and professional responsibility. My aim for this master thesis was to widen my knowledge which I gained in college by presenting it in a form of profound Mastersthesis. Therefore the aim of this thesis is to be as clear as possible for the readers, so they can be able to make a comparison between women and the role she plays in the novels of **Isa Kadare**. By helping me to a large extent as sources with more secure data, this author's novels, as well as materials from other different portals, i managed to summarize some of the key elements that should be emphasized in this thesis. I believe i have achieved, however little, in a modest way, to include the main points related to the role of women in the novels of **Isa Kadare**, that anyone who reads it to be able to understand their essence, and thus to achieve my goal on this work. As first, I am very happy to reach this point of my research and to have the chance to willfully work this Master thesis, with which I will formally mark the completion of my studies in the branch of Albanian Language and Literature.

H y r j e

Në historinë e letërsisë shqipe **Helena Kadare** hyn tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin 1970-të me romanin “**Një lindje e vështirë**”. Libri u prit mirë nga kritika. Më pas ajo rikthehet për lexuesin në fillim të viteve 90-të me romanin “**Një grua nga Tirana**”, “**Bashkëshortët**” në vitin 2002. Me një stil të veçantë rrëfimet e Helenës janë përshkruar nga një ndjeshmëri i hollë. Ajo ka një kontribut e në fushën e përkthimeve. Vitet e fundit ajo botoi librin autobiografik “**Kohë e pamjaftueshme**” ku tregon jetën e saj përkrah shkrimtarit Ismail Kadare. Udhëtimi i saj me “**Letërsia dhe qyteti**” drejt Prishtinës është një ngjarje për jetën kulturore, pasi sipas dy gazetareve nuk do të jetë thjesht një rrëfim por dhe një reflektim mbi mënyrën sesi kulturat sot ndërveprojnë me njëra tjetrën, dhe rolit të letërsisë sot në zhvillimet social-politike.

Motivi dhe qëllimi i hulumtimit:

Hulumtimi mbi këtë temë ka një rëndësi të madhe, sepse me anë të tij synoj ta paraqes femrën si figurë të rëndësishme në shoqërinë shqiptare që luan një rol pozitiv në të gjitha poret e jetës. Në romanet e **Helena** Kadaresë femra paraqitet me risitë e veta interesante dhe karakteristike. Qëllimi im në këtë punim është të përshkruaj ndikimin e saj tek lexuesit, sidomos ngritjen e vetëdijes dhe vlerësimit të femrës, karakterizimin e personazhit femër dhe dinjitetin që ka ajo në veprat e kësaj autoreje. Roli i femrës në veprat e kësaj krijuesje paraqitet në shumë dimensionë, duke filluar nga rëndësia e saj në jetën e përditshme si gërshetim i personazheve dhe kohës, realitetit dhe imagjinatës, element ky që paraqitet pikërisht në krijimtarinë e kësaj autoreje. Gërshetimin e personazhit femër dhe kohës në të cilën ajo vepron, **Helena** Kadare e ka bërë në mënyrë dinjitoze, duke e vlerësuar dhe lartësuar figurën e femrës, duke e bërë atë shumë të rëndësishme, gjë që e dëshmon në të gjitha veprat e saj. Femra për të është qenie e dashur edhe pse nga një herë e pakapshme.

Helena Kadare për femrën sajton shumë epitete të bukura, gjë kjo që nuk vjen si shprehje e ndonjë ndjenje, por njëkohësisht si përjetim i çiltër dhe shpirtëror. Ajo tregon shumë qartë se me gruan duhet të jemi të kënaqur dhe në qoftë se tek ajo shohim ndonjë të metë duhet që ta tejkalojmë, sepse nuk gjendet në botë ndonjë grua e përsosur. Prandaj, autorja mundohet të vë këtë në dukje, sepse gruaja ka nevojë të jetë e dashur me gjithë qënien e saj, me gjithë bukurinë, mangësinë, forcën dhe dobësitë. Pikërisht kjo është ajo që e paraqet rëndësinë e këtij hulumtimi.

Autorja, përmes veprave të saj, na ka dhënë mundësinë ta vështrojmë dhe ta njohim për së afërmi psikologjinë e gruas, duke zbuluar edhe ndjenjat e fshehta të grave. Ajo çdoherë i paraqet bukur karakteret e ndryshme që kanë femrat, të cilat me këto cilësi sjellin një larmi nuancash jetësore, të ndjesisë dhe psikologjisë. Me anë të këtyre veçorive autorja jep një tablo të qartë të universit femëror. Ajo i shfaq figurat e femrave si libra të hapura për lexuesit mbi botën femërore, prandaj në romanet e **Helena** Kadaresë, femrat mund ta gjejnë veten në role dhe detyra të ndryshme në shoqërinë shqiptare. Pikërisht, veprat e kësaj krijuesje janë shumë aktuale, sepse në to flitet haptas për problemet intime shpirtërore, ndjeshmërinë e tyre, naivitetin dhe sinqeritetin, duke e paraqitur një botë reale ku ata jetojnë dhe veprojnë.

2. Lënda e hulumtimit

Rëndësia e këtij studimi hulumtues shkencor ka për objekt analize letrare femrën në veprat e Helena Kadaresë. Kjo është një temë që kërkon një hulumtim gjithpërfshirës nga aspekti letrar, shoqëror, moral, edukativ dhe njerëzor. Pra, bëhet fjalë për rëndësinë e femrës në disa vepra të kësaj krijuesje në letërsinë shqiptare. Është kënaqësi e vaçant të merresh me artin letrar të saj, në të cilin shfaqet një përditshmëri me ndodhi të zakonshme. Jetësimi i krijimtarisë artistike të Helena Kadaresë çdo herë e bën të veçantë figurën e femrës duke i dhënë asaj sensin artistik të një cilësie të lartë. Krijuesja e shtyrë nga ky motiv do tu jap femrave vendin e merituar dhe të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare, sidomos kur ato ndjehen të pasigurta, të kërcënuara dhe të pambrojtura. Ato nuk e duan dhe nuk e meritojnë këtë mënyrë të jetesës, por fati i sjell në pozita inferiore, nuk kanë nga t'ia mbajnë dhe e vetmja gjë është t'u nënshtrohen fateve që ua sjell jeta dhe rrethi shoqëror. Ndoshta ky është shkaku që Helena Kadare shkruan për gra të barabarta me burrin në çdo aspekt të jetës, por edhe për gra fatzeza që e kalojnë jetën në skëterrë. Helena Kadare është çliruar me anë të shkrimit nga kjo brengë që ia rënqeth trupin, prandaj rolin që luajnë femrat në veprat e saj nuk i lë pa i shfaqur si të tilla. Ajo në disa vepra të saj do të thotë se çdo gjë e ka rëndësinë e vet dhe secila prej tyre e ka vendin që e meriton në shoqërinë shqiptare. Prandaj Helena Kadare i kushton një rëndësi të veçantë rolit të gruas që e paraqet në veprat e saj, për të cilat mund të themi se janë një himn për gratë, sepse ajo në gjithë krijimtarinë e saj ato i paraqet me gjithë virtytet e tyre duke u nisur nga ato më të larta deri tek ato më të ndërlikuara. Krijuesja i kushton rëndësi çdo gjëje që e përjeton femra, duke e paraqitur rolin e tyre vendimtar në të gjitha fushat.

Helena Kadare di të përshkruaj çdo gjendje shpirtërore që kalon femra, shqiptare duke u bazuar në ndjenjat e saj morale dhe njerëzore. Në veprat e saj femrat paraqiten kaherë si qenie shumë të dhembshme, sepse ajo është bartëse e dhembjeve të mëdha jetësore. **Helena** Kadare e njeh mirë personalitetin e gruas shqiptare dhe e përshkruan atë shumë bukur në veprat e saj. Çdo personalitet të femrës e shfaq ashtu siç është, me problemet intime, psikologjike e shpirtërore. Një tipar kryesor në veprat e saj është pamja e grave në sytë e burrave dhe në mbarë rrethin shoqëror, të cilat me cilësitë e tyre karakteristike biejnë shumë shpejt në sy, gjë që përmes këtyre tipareve mund t'i dallojmë se çfarë roli luajnë këta në romanet e saj. **Helena** Kadare e përshkruan në mënyrë të hollësishme dhe të gjithanshme pamjen e gruas, ku çdo lexues serioz dhe i mirëfillt i veprave të saj shumë qartë mund ta zbulojë karakterin e tyre. Përshkrimi i pamjes së saj i përshtatet personalitetit femëror me bukurinë shpirtërore që ka, sepse ajo është një magji që të magjeps dhe të bën peng. Autorja thotë se figura e saj ka qenë dhe është e domosdoshme në shoqërinë shqiptare.

3. Hipotezat e hulumtimit:

Lidhur me këtë hulumtim do të merren parasysh hipotezat e mëposhtme:

Ka një lidhje të ngushtë midis veprave të **Helena** Kadaresë ku në plan të parë ndeshim personazhin kryesor femër dhe në veprat tjera mund të jetë personazh dytësor.

Ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes figurave pozitive dhe atyre negative

Te disa vepra kjo krijuese zbulon aspektet kompozicionale dhe krijuese të punës dhe jetës së tyre.

4. Metodologjia e hulumtimit:

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do ti përdor metodat më të përshtatshme që i përgjigjen temës, me qëllim që të arrijm deri tek njohurit që i kemi synim që ti realizojm, pasi që përdorimi i sakt i metodave ndikon në ndërthurjen dhe shpjegimin e sakt të këtij punimi shkencor. Ky hulumtim do të realizohet përmes zbatimit të analizës së kritikës tekstuale dhe krahasimeve letrare, artistike dhe gjuhësore. Në mënyrë të veçantë do të shfrytëzohen burimet relevante të cilat i kemi në dispozicion për studimin dhe analizën letrare të veprave të kësaj autoreje, siç janë: **“Bashkëshortët”**, **“Kohë e pamjaftueshme”**, **“Një lindje e vështirë”**, **“Një grua nga Tirana”** etj. dhe krijimet tjera të korpusit të veprave të kësaj krijuesje, duke i komentuar mbi masën dhe thellësinë e ndryshimeve të bëra nga kjo autore. Qëllimi i metodologjisë së hulumtimit është që të sigurojë dëshmi që do të testojnë dhe mbështesin, apo mohojnë hipotezat. Të dy metodat, ajo kualitative dhe kuantitative të hulumtimit do të përdoren në mikrotezë.

5. Rëndësia e studimit të temës:

Rëndësia e kësaj teze të hulumtimit shtrihet në tematikën dhe përmbajtjen e cila ka të bëjë me subjektin letrar dhe ideoartistik. Kjo tezë është orientuar në përvijimin e këndvështrimit personal të **autores** dhe personazheve të veprave në fjalë, në të cilat **Helena** Kadare i ka dhënë burimet e tyre kryesore, të cilat çuan në krijimin e dy tragjedi të mëdha të periudhës elizabetiane. Kjo tezë ka për qëllim të vë në pah zhvillimin e diferencave dhe pikësnyimeve të figurave kryesore: në rastin e personazheve femra në disa aspekte në një mjedis të zakonshëm shqiptar. Prirja e **Helena** Kadaresë për t'i dhënë krijimtarisë së **saj** letrare një kuptim filozofik, në të cilin kërkon dhe e gjen shpjegimin për misterin e jetës në mes të realitetit dhe fiksionit. Ky vision do të jetë një analizë e qëllimeve, ku zbulohen ëndërrat e zemrës femërore që i përngjajnë kohës e cila ecën si ania nëpër jetë.

Pas një analize të plotë të faktorëve të përmendur më sipër, kjo punë hulumtuese letrare lind vetvetiu përmes një informacioni më të detajuar dhe specifik në lidhje me veprat që kanë objekt pasqyrimi femrën shqiptare në një shoqëri monizmi me plot peripeci, dilemash dhe misteresh. Veprat e **Helena** Kadaresë vetvetiu sikur na japin njohuri për atë që është mënyra më e mirë për të kuptuar femrën si grua, bashkëshorte, nëpunëse dhe intelektuale. Në një situatë të tillë edhe dashuria nuk është një urë shpëtimi, sepse edhe kjo vetë është diçka kalimtare, është si një gotë me ujë që avullon.

6. Struktura narrative dhe galeria personazheve:

Për të nxitur interesimin e lexuesve duhet bërë një strukturë të qartë të punimit, prandaj është e nevojshme që ne si studiues të rinjë të mendohemi që brenda mundësive tona të hartojmë një punim me vlerë të duhur dhe të mundshme. Andaj ky studim letrar paraqet një punë serioze dhe të mirëfilltë shkencore, i cili trajton tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me figurën e femrës në veprat e shkrimtares sonë **Helena Kadaresë**. Për këtë arsye konsiderojmë se element i rëndësishëm i çdo punimi është struktura e tij. Që të bëjmë një strukturë të mirëfilltë së pari na duhen njohuri të përgjithshme në lidhje me temën. Qëllimi ynë është që të paraqesim personazhin femër në romanet e **Helena Kadaresë**. Personazhi, bashkë me kohën-hapësirën, është kategori themelore e llojeve tregimtare në letërsinë tonë. Ai, zakonisht është zëdhënës kryesor i shkrimtares. Përmes tij përcaktohet dhe manifestohet ndërgjegjja individuale dhe kolektive, në të cilën shprehet këndvështrimi dhe perspektiva jetësore. Kur personazhi ngrihet në rrafsh reprezentues, shpreh dhe përcakton jo vetëm ndërgjegjen e kohës, por paralajmëron njëkohësisht edhe atë vizion dhe ndjesi që sapo fillon të duket se ka lindur në horizont. Përmes tij bëhet edhe hulumtimi i shumë breznive. Hulumtimi ynë mbi rolin e gruas në romanet e **Helena Kadaresë** është punim shumë i rëndësishëm i cili pa dyshim paraqet vlera të mëdha, sepse çdo roman i kësaj autoreje është një histori më vete, dhe çdo lexues shumë shpejt krijon një përshtypje dhe interesim të jashtëzakonshëm për krijimtarinë e **Helena Kadaresë**. Të gjitha veprat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën sepse paraqesin jetën reale. Mënyra këndvështruese në romanet e **Helena Kadaresë** është shumë e vaçantë. Për këtë arsye nuk kemi dyshim se shkrimtarja trashëgon vlerat më të mira të realizmit real.

Helena Kadare i paraqet femrat si një faktor tepër të rëndësishëm për shoqërinë. Gruaja është një personalitet i përsosur, prandaj edhe autorja ia jep të gjitha të drejtat që përkojnë me natyrën e saj. Me një fjalë, ajo e mbështet figurën e gruas dhe i kushton vëmendje të madhe. Për të kjo qenie ka vlera të mirëfillta në shoqëri, prandaj i paraqet gratë si nismëtare të ndryshimit shoqëror. Femra në përgjithësi ka qenë më pak e pranishme nëpër pozicionet ku ishte burri, por ajo, edhe pse është ndjerë e mënjanuar në këtë aspekt, femra gradualisht filloi t'i ketë rolet e ëndërruara, pavarësisht rrethanave në të cilat ka jetuar. Ajo ëndërron përsëri dhe, në të shumtën e rasteve, ëndrrat e saj janë të thjeshta dhe të pazakonta ashtu siç janë dhe rrethanat në të cilat ajo ëndërron.

Teza e masterit është e strukturuar në pesë pjesë, ku secila ka të bëjë me analizën e figurës së femrës në romane, dhe rolin e saj që luan në to. Duke bërë krahasimin në mes romaneve se çfarë rëndësie ka femra në krimtarinë e Helena Kadaresë, pra stuktura në vijim mund të jetë një pikë e mirë filluese për strukturimin e këtij punimi.

7. Jeta dhe veprimtaria letrare e Helena Kadaresë

Me anë të përshkrimeve që bën, fare lehtë mund ta dallojmë se çfarë roli luan gruaja në roman, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra, sepse ajo e vlerëson figurën e gruas shumë lartë, duke e paraqitur atë si qenie të bukur. Femra paraqitet e pacënueshme, ndërsa në disa nga romanet e saj ajo del e shtypur në familje dhe në shoqëri, pa asnjë lloj autoriteti, pa dinjitet dhe tepër e përbuzur. Me një fjalë, romanet e **Helena Kadaresë** janë plot copëza të jetës së vërtetë. Jeta e femrave është shumë interesante. Secila prej tyre ka personalitetin e vet, është një femër tekanoze dhe e pavarur e cila e bën romanin më tërheqës për lexuesit. Këto femra janë të veçanta dhe ndryshojnë shumë për nga karakteri. Thjesht, secila prej tyre **paraqet një botë më vete**.

Helena Kadare e përshkruan bukurinë femërore duke i idealizuar veçoritë dhe virtytet e saj. Edhe pse bukurinë e një gruaje e shfaq vetëm në një skicë, në të cilën është karakteri ai që e bën një femër të jetë kryevepër në vete. Këtë gjë e bën në mënyrë të përkryer, duke u munduar përmes kësaj figure, t'i shfaqë qëndrimet e veta për jetën e njeriut në përgjithësi. Andaj, gruaja në romanet e H. Kadaresë paraqitet si intelektuale që është në gjendje të formësojë preokupimet e veta dhe të luftojë për to. Shumë personazhe femra që i hasim në veprat e saj, i kundërvihen realitetit me jetën që e ndërtojnë. Përmes figurës së gruas, Helena Kadare në veprat e saj vazhdon betejën morale për emancipimin e gruas. Ajo është e lidhur ngushtë me rrethin dhe kohën në të cilën jeton. Shkrimtarja e bën personazhin femër të flasë për fuqinë e gruas që është në gjendje t'i kundërvihet së keqes. Në shumë romane H.Kadare dëshmon kujdesin e madh dhe rolin që luan femra në jetë.

Duke e ngritur atë në nivel mirësie dhe bukurie, ajo mundohet t'i shmanget së keqes që e rrethon. Figura e gruas sipas Helena Kadaresë jeton në periferi të jetës. Fati që e përcjell gruan nuk është i përcaktuar nga përkatësia e klasave, sepse tragjikën e jetës e ndiejnë njëjtë femra e varfër dhe e pasura. Shfaqet me ëndërra të parealizuara që e kupton jetën si dështim.

Në veprat e **Helena Kadaresë** vend të veçantë zë edhe dashuria e **femrës**, e cila mbretëron si kuptim i përjetësisë. Kjo dukuri është fuqi që shkatërron çdo gjë para vetes dhe e vetmja që i bën ballë kësaj fuqie është femra. Jeta, qoftë si nocion filozofik apo real, për **Helena Kadare** ka kuptim vetëm nëse në të bën pjesë femra si simbol i dashurisë dhe bukurisë. Me përmbajtjen e veprave të saj, kjo shkrimatare i nxjerr në pah të gjitha të metat e shoqërisë. Gruaja në romanet e saj del e shtypur dhe pa botën e saj të pavarur. Me të manipulon shoqëria edhe familja. Ajo është e tjetërsuar e përbuzur dhe herë-herë vihet në shërbim të së keqës nga e cila së pari e pëson vetë. Autorja këto probleme i shfaq në vepra me qëllim, që shoqëria t'i luftojë padrejtësitë që i bëhen gruas, me shpresë se një ditë do të mund ta shijojnë triumfin e fitores. Figurës së gruas **Helena Kadare** i kushton rol shumë të rëndësishëm. Është treguese e përgjithshme e vuajtjeve njerëzore. Në disa shkrime është në gjendje që nuk mund ta jetojë as rininë e saj. Në këtë mënyrë femra ka për qëllim të demaskojë mendimin prapanik viktimë e të cilit është vetë ajo. Dhembjen e këtyre femrave nuk e sheh askush, sepse çdonjëri mundohet t'i harrojë ato sa më shpejt. Sepse këto femra do t'u ngjallnin atyre përdëllim të cilin ata nuk ia dëshirojnë vetes. Si gjithë femrat e tjera edhe ata e duan jetën, prandaj durimi i tyre është i madh, ashtu si dashuria që ka për jetën.

Ajo i bën ballë çdo gjëje dhe e duron edhe barrën që i rëndon mbi kurriz, vetëm që të ketë jetë të qetë dhe të gjejë lumturinë. Këto femra ndiejnë vetmi të madhe nga që hidhen në krahët e atyre që nuk i meritojnë. Duke ua dhuruar shpirtin të tillëve, ato qëndrojnë të heshtura përballë një dhembjeje të madhe. Ata shpesh qeshin dhe shfaqen të lumtura, ndërkohë që zemra u qan. Figura e femrës është paraqitur me të gjitha virtytet e gruas së zakonshme. Ajo di ta tregojë karakterin e gruas besnike, e cila është *genie* delikate, e ndjeshme dhe me plot ëndërra për *jetën*, është një heroinë dhembshurie.

8. Përfundimi.....

Në përfundim mund të themi se, veprat e **Helena Kadaresë** janë një thesar i vërtetë, plot me vlera. dhe përbëjnë një material shumë të vlefshëm për t'u analizuar dhe për t'u diskutuar. Personazhet e **Helena Kadaresë** janë sa të çuditshëm aq dhe të zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

Ky punim diplome është një përpjekje modeste për të dëshmuar edhe njëherë se brenda formësimit aktual dhe praktik të shenjave gjuhësore shihet një botëkuptim i caktuar i cili shpreh cilësitë shpirtërore të popullit që e flet dhe se gjuha është një realitet mendësor, kulturor, etnografik, shoqërorë.

Me të drejtë kjo autore konsiderohet si një zë i çmuar në letërsinë tonë. Helena Kadare është shembull femre për krijueser që do vine më pas, veprat e saj sjllin stile të dukshme në letërsinë shqipe.

Veçojmë në këtë studim veprat letrare të Helena Kadaresë të cilat duhet të vijnë tek brezat e rinj, për t'i shtyrë ata drejtë një formimi të plotë letrarë. Mendojmë se duhet orientuar kahu studimor por të reflektuar mbi motivet dhe mënyrat e të shkruarit dhe të gjykuarit të letërsisë, sepse përmes Helena Kadaresë njohim letërsinë e mirfilltë. Ajo që e bën të qëndrueshme këtë krijuese janë vlerat e saj artistike dhe letrare ku pasqyrohen skenat e qëlluara për mbarështrimin e temës kryesore.

Helena Kadare u mundua të paraqitet në mënyrë reale dhe të besueshme para lexuesit. E tregon në këtë formë pa mos e fshehur në romanet e saj, duke e bindur lexuesin se historia njih zhvillimet shoqërore, por që e sfidon me qëndresë. Romanet e saj janë të veçantë, në disa prej tyre gjatë leximit vërejmë një motërzim të dyfishtë. Kuptojmë se është e njëjta ngjarje por që i ndryshon vetëm titulli na duket se është karakteristikë për nga qëndresa e femrës shqiptare. Në romanet e saj shohim personazhe që flasin për kohën. Në shërbim të këtij punimi kemi spikatur personazhët që përbëjnë prozën e **Helena Kadaresë** që është në harmoni me kohën. Duke e analizuar detajisht qarkun tematik në veprat e saj shpresojmë që janë thënë gjërat më thelbësore, por që gjithsesi kemi lënë hapsirë që edhe studiues të tjerë të merren me të njëjtën temë, sepse për këtë krijuese nuk ka mbaruar gjithçka. Të flasësh vetëm për një vepër të saj nuk mjafton, por duhet lexuar dhe studiuar të gjitha veprat e saj, sepse janë një burim i pashtershëm.

Bibliografia.....80

1. Kadare H., **Një lindje e vështirë**, Tiranë, 1970
2. Kadare H., **Një grua nga Tirana**, Tiranë, 1990
3. Kadare H., **Bashkëshortët**, Tiranë, 2002
4. Kadare H., **Kohë e pamjaftueshme**, 2011
5. Kadare I., **Përballë pasqyrës së një gruaje**, Onufri 2001, Tiranë, 2001
6. Kadare I., **Unaza në kthetra**, Onufri, Tiranë, 2004
7. Aliu A., **Vepra të zgjedhura III**, Shkup, 2005
8. Xhaferi H. **Semantika e dashurisë në romanin**
9. **"Nata me hënë"** të Ismail Kadaresë

Të merresh me **Elena Kadarenë** sot mund të konsiderohet privilegj. Gjithashtu, për shkak të aurës së saj artistike e personale të krijohet ndjenja e të voglit, duke luftuar vazhdimisht vetëm me veten, e duke mëtuar ta realizosh punën tënde në nivel të emrit të saj. Duke kërkuar, hulumtuar, lexuar, pastaj shkruaj fjalët, rrjeshtat, faqet dhe sërish je me mëdyshje se gjer në çfarë mase kam arritur t'i qëndroj përballë kësaj poeteshe dhe romancierje të quajtur **Helena Kadare**. Pa dyshim që kjo krijuese është një ndër personalitetet e pakta shkrimtare dhe romanciere shqiptare, duke filluar që nga vitet e regjimit komunist. Figura e saj krijon mundësi të shumta për t'u trajtuar dhe hulumtuar, në nivele shumëdimensionale, me çasje dhe perspektiva të llojllojshme. Autore e shtatë vëllimeve, veprat e saj flasin për ëndërrimet vajzërore, përjetimet e të bashkëshorte. Po ashtu figura e saj mund të jetë subjekt studimi nga studiues me profile të ndryshme. Veprat letrare të saj mund të studiohen si tërësi, apo veç e veçë.

Perspektiva artistike konsiston në vlerat artistike që bartë vepra e saj. Lidhjen e tyre me fushat e tjera të artit dhe me mundësitë që krijon për bashkëveprim me format tjera **artistike**. Gjithashtu është një përkthyes cilësore e disa veprave të autorëve të njohur botërorë, kryesisht francezë. Helena është bashkëshortja e autorit të famshëm shqiptar, Ismail Kadare. Së fundmi është botuar nga Shtëpia Botuese "**Onufri**" libri biografik "**Kohë e pamjaftueshme**", në të cilin rrëfen gjerësisht për bashkëjetesën e saj me Kadarenë. Vepra e **Helena Kadaresë** është me vlera të pasura për të sotmen dhe të ardhmen e kombit tonë. Është një thesar i çmuar kulturor në plejadën e krijueseve modern e cila rrëfen një rrëfim të rrallë mbi udhëtimin e pazakontë të një gruaje në lertërsi.

Helena ka një kontribut të konsiderueshëm në fushën e përkthimeve, mjafton të kujtojmë për shembull **“Tri gratë”** e japonezit **Isushi Inoe** apo **“Një grua në Berlin”** ditar i një autoreje anonime, gjermane, që përshkruan javët nga 20 prilli deri në 22 qershor 1945.

Helena Kadare ka mundur t’i japë Singerit, këtij shkrimtari të madh të letërsisë botërore jetë në gjuhën shqipe, duke shqipëruar dy nga veprat e tij më të rëndësishme si **“Dashuri e vonë”** apo **“Shosha”**. Me një aftësi për të përshkruar gjithë dimensionin e ndjeshmërisë së këtij shkrimtari, ajo e ka bërë veprën e **Singerit** të paharrueshme në shqip. **“Shosha”** është një nga romanet që ajo rekomandon për të lexuar në listën prej 10 librash që nuk duhen humbur pa lexuar. Kjo Krijuese spikat me shumë ide të qarta dhe të përmbushura në mënyrë intelektuale, na përshkruan shumë pjesë nga jeta e disa prej femrave. Kjo për shkak se Helena Kadare është njohëse shumë e mirë e traditës tonë, e mendësisë dhe nivelit të emancipimit, e artit të fjalës dhe historisë dhe filozofisë. Vepra e saj është realizuar në forma të ndryshme artistike me vlera të veçanta poetike dhe artistike. Në këtë kuptim, për të gjithë studiuesit potencialë të kësaj krijesje, është sfidë për gjetjen e një teme origjinale dhe të pa trajtuar më parë për këtë personalitet.

Por, sfida kryesore ka të bëjë me gjetjen e kësaj teme të shtjelluar mjeshtërisht, e cila do të kontribuojë në studimin më të thelluar të **H. Kadaresë**, nga një dimension të patrajtuar më parë, që do të kontribuonte në fushën të cilës i takon kjo temë dhe njëkohësisht do të ishte një material i mirë leximi dhe referuese për lexuesit dhe studiuesit tjerë. Duke u bazuar në temat që trajton **Helena Kadare** në veprimtarinë e saj, mund të konsiderohet se veprat e saj i takojnë krijimtarisë së angazhuar. Duke filluar që nga romanet "**Një lindje e vështirë**", Novelë, 1970. Andaj në historinë e letërsisë shqipe Helena Kadare hyn tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin 1970-të me romanin "**Një lindje e vështirë**" i cili u prit mirë nga kritika. Më pas ajo rikthehet për lexuesin në fillim të viteve 90-të me romanin "**Një grua nga Tirana**", novelë, 1990 dhe "**Bashkëshortët**" në vitin 2002. rrëfimet e Helenës janë përshkruar me një stil të veçantë dhe një ndjeshmëri të hollë.

Në historinë e letërsisë shqipe **Helena Kadare** hyn tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin 1970-të me romanin "**Një lindje e vështirë**". Libri u prit mirë nga kritika. Më pas ajo rikthehet për lexuesin në fillim të viteve 90-të me romanin "**Një grua nga Tirana**", "**Bashkëshortët**" në vitin 2002. Me një stil të veçantë rrëfimet e Helenës janë përshkruar nga një ndjeshmëri i hollë.

Ajo ka një kontribut e në fushën e përkthimeve. Vitet e fundit ajo botoi librin autobiografik **“Kohë e pamjaftueshme”** ku tregon jetën e saj përkrah shkrimtarit Ismail Kadare. Udhëtimi i saj me **“Letërsia dhe qyteti”** drejt Prishtinës është një ngjarje për jetën kulturore, pasi sipas dy gazetareve nuk do të jetë thjesht një rrëfim por dhe një reflektim mbi mënyrën sesi kulturat sot ndërveprojnë me njëra tjetrën, dhe rolit të letërsisë sot në zhvillimet social-politike. Krijuesja në romanin **“Bashkshortët”** në fillim të veprës lexuesit i jep të imagjinoj një femër të re e cila nuk e kishte idenë se çfarë e pret pas martesës.

Dëshironte vetëm të bashkohej me njeriun e zemrës. Krijimtaria e saj duket se është si një ushqim i shpirtit. Vepra e saj qoftë në prozë apo në poezi duket se është si ushqimi i shpirtit. Perspektiva e saj ndaj temave dhe ngjarjeve të cilat si të tilla shumë shpesh të hutojnë. Por, sfida kryesore ka të bëjë me gjetjen e një teme të caktuar, e cila do të kontribuonte në studimin më të thelluar të **Helena Kadaresë**.

Duke u nisur nga një dimension të patrajtuar më parë, që do të kontribuonte në fushën të cilës i takon kjo temë dhe njëkohësisht do të ishte një material i mirë leximi referues për lexuesit dhe studiuesit e tjerë. Gjatë studimit të thukët të veprës së saj, konstatohet se **Helena Kadare** veprën e saj letrare e ka të ndërtuar mbi baza të forta dramatike, në aspektin e krijimit të fabulës, zhvillimit të ngjarjes, ndërtimit të karaktereve.

Rrugëtimi i Helena Kadaresë me krijimin e saj **“Letërsia dhe qyteti”** drejt Prishtinës është një ngjarje që ka të bëjë me jetën kulturore, pasi sipas dy gazetareve nuk do të jetë thjesht vetëm një rrëfim por dhe një reflektim mbi mënyrën sesi kulturat sot ndërveprojnë me njëra tjetrën, dhe rolin e letërsisë në të sotmen në zhvillimet letrare dhe artistike. Është interesante letërsia e kësaj autoreje për arsye se është bazuar te historitë personale të kësaj krijuese letrare. Por ndër të tjera vërejmë se vetë Ismail Kadare, ka futur jetën e tij personale, në disa libra të saj, bile edhe në ndonjë rast marrëdhënien me **Helenën**, siç është te **“Përbindëshi”**, ku personazhi **Ana**, në fakt është vetë **Helena**, janë takimet e saj të para me **Ismail Kadarenë...** Madje zgjodhi një fat tragjik për **Anën**. ... Dhe në fakt të gjitha **Anat** kanë një fat gati tragjik në veprën e tij, sikurse edhe tek **“Aksidenti”**. Anën, e ka një personazh shumë të dashur, e ka përdorur shpesh si emër në libra.

Motivi dhe qëllimi i hulumtimit:

Motivi i parë që më shtyu të zgjedh këtë temë ishte se **Helena Kadare** është njëra ndër krijueset e njohura në letërsinë moderne shqiptare. Kjo duket se është një muze i gjallë në krijimtarinë e saj letrare. Rëndësi të veçant ka proza e saj e cila përshkruan periudhën kur shqiptarët në përgjithësi kishin një ëndërr të përbashkët që aspironin për një jetë të re pa brenga. Duke u marrë me krijimtarinë letrare të saj, mësova për praninë e mendimit të lirë, që është karakteristikë e vlerësimit të krijimtarisë së saj. Kjo krijuese do mbetet udhërrëfyese e mendimit demokratik dhe të urtësisë, duke qenë një realiste e çiltër, e guximshme dhe e hapur. Në krijimtarinë e saj letrare dhe publicistike jetojnë të shprehura artistikisht ndjeshmëria dhe mençuria popullore. Pikërisht për këtë arsye qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë trajtimi i koncepteve letrare, artistike dhe estetike të kësaj krijuesje. **Helena Kadarenë** e ka karakterizuar një ideal vetjak estetik dhe në kuadrin e kulturës lëndore e shpirtërore.

3. Lënda e hulumtimit:

Hulumtimi kërkimor apo mbi **gjurmimin** është "puna kreative letrare dhe artistike e ndërmarrë në mënyrë sistematike duke përfshirë njohuritë mbi figurën e femrës në veprat e Helena Kadaresë, që ka të bëjë me njerëzit, kulturën dhe shoqërinë shqiptare dhe përdorimin e kësaj njohurie për të hartuar aplikime të reja. Ky hulumtim studimor ndërmirret për të krijuar dhe konfirmuar zhvillimet letrare në letërsinë shqipe, duke riafirmuar rezultatet e një pune letrare dhe artistike të mëparshme, zgjidhjen e problemeve të reja apo ekzistuese mbi letërsinë dhe artin letrar shqiptar, duke zhvilluar një teori të re letrare dhe artistike. Andaj ky studim hulumtues dhe letrar mund të jetë një zgjerim mbi punën e kaluar në fushën e letërsisë shqipe. Duke vlerësuar artin letrar shqiptar. Ky hulumtim mund të përsërisë elementet e projekteve të mëparshme letrare në tërësi. Gjithashtu ndeshim edhe disa forma të hulumtimeve shkencore, artistike dhe shorërore në letërsi.

4. Qëllimi i hulumtimit:

Qëllimet e këtij punimi janë:

- Të njihemi më mirë me autoren Helena Kadare dhe veprimtarinë e saj.
- Të thellohem më gjerësisht në analizën e romaneve: "**Një lindje e vështirë**", Novelë, 1970. Në historinë e letërsisë shqipe **Helena Kadare ka** hyrë tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin 1970 me romanin e parë të saj "**Një lindje e vështirë**", një roman i shkruar në vitet '70. Helena Kadare thotë se ka shkruar shumë herët, por lidhja me Ismailin atë e ka bërë të mendoj se, çfarë do të thoshte ai, për ato që unë shkruaja. Ma lexoi fillimisht ai atë roman dhe i ka thënë "Mirë, nuk është i keq. Por jo kushedi se çfarë. Mos kujto se çfarë ke bërë", më tha. Pastaj ai roman u botua dhe u prit shumë mirë nga publiku. Siç është e njohur libri i saj u prit mirë nga kritika. Më pas Helena Kadare rikthehet për lexuesin në fillim të viteve '90-të me romanin "**Një grua nga Tirana**", Novelë, 1990, janë këta **takimet e para të Helenës me Ismailin**. Pothuajse gjithë librat e saj, që erdhën më pas, duke filluar nga titujt "**Bashkëshortët**", Novelë, në vitin 2002. Me një stil të veçantë rrëfimet e Helenës janë përshkruar nga një ndjeshmëri i hollë, siç është "**Kohë e pamjaftueshme**", Novelë, 2011, duket sikur janë një autobiografi e saj. Kjo, do të thotë se Helena Kadare është frymëzuar nga realiteti dhe nga historitë e jetës së saj. Është interesante te letërsia e saj se është bazuar te historitë personale. Por njëkohësisht edhe Ismail Kadare, ka futur jetën e tij në disa libra biles në ndonjë rast edhe marrëdhënien me Helenën, siç është te "**Përbindëshi**", ku personazhi **Ana**, në realitet është vetë Helena.

Andaj **Anën**, e ka një personazh shumë të dashur, e ka përdorur shpesh si emër në libra. Ai thoshte se “në qoftë se duhet të shkruash diçka, duhet ta shkruash në mënyrë të tillë që ta pëlqejnë ballkanasit, sepse ata vetë, i shpërdorojnë këto gjëra dhe më tepër janë narrative. Helena Kadare do të thotë se kjo më dha mundësinë e mirë që t’i shkruaja historitë pa droje. Ajo tregon se Ismail Kadare e ka mësuar të shkruaj gjithmonë atë që mendoj, pa bërë dredha, sepse lexuesi ka një ndjeshmëri të jashtëzakonshme. Gjatë jetës shkrimore të saj ka pasur shumë momente të vështira nga pushteti komunist. Njëri ka qenë kur u bllokua botimi i poemës “**Pashallarët e kuq**”. Ka qenë një e diel me shi dhe unë thotë Helena, për habinë time, ndihesha edhe pak euforike. Ky ka qenë një moment shumë i vështirë për të dy bashkëshortët Helena dhe Ismail Kadare.

- Të gjenden temat që trajtohen në këto romane
 - Të përcaktohen veçantitë e veptave të kësaj autoreje dhe çfarë e bën këtë autore kaq të veçantë dhe kaq të lexuar.
 - Të analizojmë se ku është frymëzuar autorja për të shkruar romanet si dhe çfarë qëllimi ka pasur apo çfarë mesazhi ka dashur të dërgojë te lexuesit.
- Përfundimisht, përmes këtij punimi synohet që të shtjellohet krijimtaria letrare e **Helena Kadaresë** në një aspekt jo të zakonshëm të saj, pra në një dimension shumë pak të eksploruar, në lidhjen e saj me artin skenik, respektivisht me artin letrar, duke u përqëndruar në veprat letrare të kësaj krijuesje. Helena Kadare ka mbetur po ajo, krijuesja grua që i shpërndahet një dritë ndër flokë, që duket se vjen nga thellë brenda saj. Më pas gjithë jeta e saj do të orvatej rreth letërsisë. Në këtë mënyrë ajo u shoqërua me vështirime lexuesish që gjenin tek ajo jo vetëm shkrimtaren, por edhe gruan që me modelin e saj i ka emancipuar dhe frymëzuar gratë shqiptare, siç janë veprat “**Një grua pamjaftueshme**”, të cilat janë vepra thelbësore të saj

5. Metodologjia e hulumtimit:

Në bazë të qëllimit të punimit, metodologjia e kërkimit mbështetet në veprat e Helena Kadaresë. Veprat analizohen secila në veçanti dhe arrihet përfundimi.

Për tu përgatitur ky punim janë përdorur këta metoda:

1. Metoda teorike
2. Metoda komparative (krahasuese)
3. Metoda deskriptive (përshkruese)
4. Metoda analitike
5. Metoda sintetike
6. **Burimet e literaturës**
7. Burimi fillestar – veprat e autores (Helena Kadare)
8. Burimi sekundar – Biblioteka universitare dhe
9. Biblioteka e qytetit

6. Metodatat dhe procedurat e hulumtimit

Natyra e kësaj teze të magistraturës më imponon domosdoshmërisht përdorimin e metodave bazë, siç janë: metoda **deduktive** dhe **induktive**. Përveç këtyre metodave do të përdoren edhe metoda tjera, siç janë: **Metoda hulumtuese** e cila bën riprodhimin e plotë në formë të shkruar të formës së folur, në të cilën hasen forma të ndryshme, pra forma të cilat individit i përdor në të folurit e tij të zakonshëm. Vlen të theksohet se kjo formë e komunikimit është e ndikuar mjaft nga anglishtja. Përmes **metoda deskriptive** – do të orvatem t'i prezentoj dhe përkufizoj nocionet bazë të cilat kanë të bëjnë me këtë temë. Rezultatet e hulumtimeve të mia, gjithashtu do të përshkruhen dhe sqarohen. Ndërsa përmes metodës analitike rezultatet e hulumtimeve dhe tërë materiali i mbledhur do të analizohen, ndërsa më kryesoret do të prezantohen në këtë punim të magistraturës. Me anë të metodës krahasuese do të realizohet analiza krahasuese e rezultateve lidhur me veprën letrare të Helena Kadaresë.

7. Rëndësia e studimit të temës

Ku hulumtim studimor ka vlerë të rëndësishme për artin letrar, para së gjithash, për vetë faktin se trajtohet një temë mjaft aktuale, që gjer më tani në kulturën letrare shqiptare nuk i është dhënë rëndësi të mjaftueshme dhe nuk është hulumtuar sa duhet. Shkaku kryesor për këtë është përdorimi i emotikoneve. Nga ana tjetër, përmes këtij hulumtimi është me rëndësi esenciale që përdoruesit të njoftohen me këtë problematikë. Helena Kadare do të qëndroj gjithashtu, si një femër fisnike së cilës gjithmon i shpërndahej një dritë ndër flokë, që duket se vjen nga thellë brenda saj.

8. Hipotezat e hulumtimit:

Shqipja standarde si kod frmal, sot haset kryesisht në ueb faqet e institucioneve qeveritare e publike në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe në ueb faqe informative, pra të mediave të ndryshme në gjuhën shqipe. Në ueb faqe të ndryshme, përdoret më shumë në formën e shkruar, por edhe në formë audio-vizuele të materialeve. Sa i përket respektimit të normës standarde dhe në raste tjera. (Munishi, 2006: 139-141).

Në shoqërinë shqiptare hasim karakterin e njerëzve të quajtur **“Pashallarët e kuq”**, të cilët do ta bllokojnë botimin e saj. Njëri prej tyre ka qenë kur u bllokua botimi i poemës në fjalë, i cili ka qenë një moment shumë i vështirë. Pra ka pasur shumë momente të tilla. Ne të asaj kohe, të atij universi, thotë Helena Kadare, i njihnim shumë mirë ato kode, se çfarë donin të thoshin. Helena thotë se kemi përjetuar në familjen tonë akuza të shumta që i janë bërë Kadaresë, si “shkrimtar i oborrit”, apo si “shkrimtar që i ka shërbyer regjimit”. Fakti që Helena dhe Ismail Kadare kanë një vetëdije të plotë për atë që kemi bërë dhe që lexuesit janë me mijëra e tregon vlerën e letërsisë së tyre. Lexuesit e vërtetë, ai që e donte librin dhe që e donte Ismailin dhe Helenën, e kuptonin menjëherë në mes rreshtave atë që donte të

thoshte ai. Përballë këtyre akuzave të postkomunizmit, është vepra që e tregon vetë çdo gjë. Në qoftë se ata nuk duan ta shohin kjo është tjetër punë.

- 38 -

9. Letërsia bashkëkohore shqiptare

Letërsia bashkëkohore shqiptare mbush sado pak zbrazëtinë që ka krijuar mungesa e botimeve të plota studimore për letërsinë shqiptare të zhvilluar në gjysmën e dytë të shek. XX. Ky studim i masterit qëndron ndërmjet studimit dhe një krijimi të rëndomtë në komunikimin letrar, i kushtohet krijuesve të fushës së letërsisë si dhe të gjithë lexuesve të tjerë. Duke qenë të vetëdijshëm për mungesën e disa prej teksteve ngas letërsia bashkëkohore që u mungojnë nxënësve dhe studentve të letërsisë, veçanërisht për letërsinë bashkëkohore shqiptare, po ju ofrojmë këtyre këtë studim ndihmës, që vjen në vazhdimësi. Në këtë studim modest të letërsisë u jemi përmbatur disa kritereve, duke i analizuar veprat më përfaqësuese të letërsisë bashkëkohore. Po ashtu materiali teorik ilustruhet me pjesët më të arrira artistikisht të këtyre veprave dhe autorëve të tyre. Janë vendosur në një rrjedhë të përbashkët autorë dhe vepra siç janë Ismail dhe Helena Kadare për të dhënë më të plotë nocionin “Letërsi bashkëkohore shqipe. Ky kriter është ruajtur dhe në zgjedhjen e autorëve. Qëllimi ynë është që ky studim letrar t’u

drejtohet të gjithë lexuesve shqiptarë. Trajtohen gjithashtu dukuri historike dhe letrare të gërshetuara natyrshëm me njëra-tjetrën.

- 39 -

Ato karakterizohen me emra dhe vepra të shkrimtarëve që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e letërsisë shqiptare tashmë me individualitet të formuar, siç bie fjala Ismail Kadare dhe Helena Kadare. Në radhë të parë, është mungesa e botimeve të plota, të institucionalizuara, për letërsinë bashkëkohore shqiptare, siç bie fjala në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Për këto treva shqiptare shkakton vështirësi vetë natyra komplekse që ka zhvillimi i letërsisë shqiptare, qoftë përse i përket dukurive specifike politike dhe ideologjike serbe brenda kufijve të këtyre trevave. Ndërkaq dihet dhe përballja me vështirësitë dhe subjektivizmin që ka hartimi i një teze studimore të magistraturës time për “Letërsinë e të gjallëve” në këto treva shqiptare.

10. Helena Kadare: Jeta përkrah Ismail Kadaresë

Gati 40 vjet nga udhëtimi i parë në Kosovë, Helena Kadare rikthehet sërish këtë fillim vjeshte në Prishtinë në një takim me lexuesit. Ka mbetur po ajo, gruaja që i shpërndahet një dritë ndër flokë, që duket se vjen nga thellë brenda saj. Ndoshta është letërsia ky pasion që ajo e takoi herët që kur ishte ende fëmijë duke u përpjekur të lexonte çdo libër që i binte në dorë në qytetin e saj të lindjes në Elbasan. Më pas gjithë jeta e saj do të orvatej rreth shkrimeve të saj dhe letërsisë. Qindra lexues të rinjë e të reja do të zënë vendet e tyre në kuadër të projektit “Letërsia bashkëkohore shqipe”. Asnjëherë më parë nuk kishim parë kaq shumë lexues për një autore, që në të ftohtin e mbrëmjes së Prishtinës rrinin thjesht për ta takuar Ismail Kadarenë dhe shkrimtaren e tyre të dashur Helena Kadarenë. Përgjatë gjithë rrëfimit të tyre, Helena Kadare do të shoqërohet me vështrime lexuesish që gjenin tek ajo jo vetëm shkrimtaren, por edhe gruan që me modelin e saj ka emancipuar e frymëzuar gratë shqiptare. Më poshtë po përpiqemi të japim një pjesë të kësaj bisede. Disa studentë dhe studente të Universitetit të Prishtinës të parët ia nisim bisedës lidhur me udhëtimin e parë të Helena Kadaresë me një grup shkrimtarësh kosovarë. Si vjen në kujtimet tua zonja Kadare ky udhëtim?

Helena Kadare thotë se për herë të parë kam ardhur në Prishtinë në vitin 1980, si pjesë një grupi nga Lidhja e Shkrimtarëve që kryesohej nga Dritëro Agolli. Kemi qenë me shkrimtarët e tjerë si Eglantina Mandia, Zija Çela, Shefqet Musaraj e tjerë. Asgjë nga udhëtimet e mia të mëvonshme nëpër botë, nuk e arrin atë lumturi të këtij udhëtimi të parë në Kosovë.

- 41 -

Është udhëtim i papërshtueshëm. Pas atij udhëtimi unë kam shkruar një sërë tregimesh, që kishin të bënin me Kosovën. Gjatë atij udhëtimi vizituam edhe Pejën. Një vit më pas erdha përsëri në Kosovë, me Ismailin, ku qëndruam rreth një javë dhe shëtitëm nëpër Kosovë, Pejë, Gjakovë etj.

Më kujtohet që rrinim te “Hotel Grand”, i cili sapo ishte hapur dhe neve na dukej shumë luks dhe kur ktheheshim në mbrëmje në hotel gjithë holli i tij ishte i mbushur me studentë që na prisnin. Kur kemi ardhur në Kosovë dy muaj pas luftës, një punonjës, që punonte në sportelin e të njëjtit hotel na ka thënë: “Ju nuk e dini, por gjithë kohës ishit të përgjuar dhe pas largimit tuaj, shumë nga ata studentë që ju prisnin ju, pësuan reprezalje”.

Do donim t’ju pyesnim për zanafillën e njohjes suaj me Ismail Kadarenë. Ka qenë një tregim i juaji i botuar në një gazetë të kohës, i cili do t’i tërhiqte vëmendjen Kadaresë, që aso kohe ishte student në Moskë. Pas këtij tregimi ai ju shkroi një letër dhe kështu nisi “aventura” juaj me Ismail Kadarenë...

Isha gjimnaziste kur botova atë tregim, ndërsa Ismaili ishte me studime pasuniversitare në Moskë. Pasi kishte lexuar këtë tregim, më shkroi katër rreshta: “Lexova tregimin tuaj të mrekullueshëm...”. Dhimitër

Xhuvani, një shkrimtar nga Elbasani, i cili ndodhej edhe ai në Moskë, i kishte thënë Ismailit: “e njoh unë këtë vajzë”. Kur erdhi në verë në Shqipëri, Ismaili më tha se “nuk është se më pëlqeu vërtet ai tregim, por kisha tjetër qëllim...”.

- 42 -

Pastaj vijuan shumë letra të tjera deri te takimi im i parë. Letrën nga Moska e mori vesh i gjithë gjimnazi në Elbasan. Unë ju përgjigja menjëherë, me disa faqe letër, por nuk mora ndonjë përgjigje. Ju jeni një nga shkrimtarët e para femra të pasluftës apo kohës së diktaturës. Fakti që ishit bashkëshortja e Ismail Kadaresë, a ka qenë edhe një sakrificë e juaja, në raport me krijimtarinë tuaj letrare?

Unë e dija këtë fakt dhe e kisha pranuar. Por, ndihesha e privilegjuar se isha e para që kaloja nëpër duar, lexoja e para, krijimtarinë e Ismailit. Gjithashtu, mendova, se përballë asaj që mund të shkruaja unë, ndihma ndaj atij, vlente më shumë.

Unë iu përkushtova kësaj gjëje me bindje të plotë, se ia vlente shumë më tepër se 20–30 librat e mi që do kisha bërë. Ju nisët të na tregoni për njohjet tuaj me Kadarenë... Megjithatë, historia juaj e dashurisë nuk ka qenë e lehtë. Do të donim të dinim, kthimin e tij nga Moska, takimin tuaj të parë hyrjen tuaj të parë në familjen Kadare, emocionet e para kur e patë... si ishte ai si karakter, ju tërhoqi më tepër kur u përballët fizikisht...?

Ndërkaq unë erdha studente në Tiranë. Rastësisht në Bulevard përballem me Ismailin, i cili ishte me Nasho Jorgaqin. “Ja kjo është Helena

Gusho, siç kisha mbiemrin e vajzërisë”, i thotë Nasho. Ai aty për aty shënoi numrin e telefonit dhe më tha, “më merr në telefon, se kam sjellë edhe disa filma dhe unë i shoh në tavan”. Unë u mahnita shumë... Ma tha troç: “hajde të shohim filma në tavan!”. Le të flasim për romanin tuaj të parë “Një lindje e vështirë”, një roman i shkruar në vitet ’70. Jeni pothuajse gruaja e parë që shkruani një roman. Si e shkruat atë vepër?

- 43 -

Kam shkruar shumë herët, por lidhja me Ismailin më bëri të mendoja se, çfarë do të thoshte ai, për ato që unë shkruaja.

Ma lexoi fillimisht ai atë roman. “Mirë, nuk është i keq. Por jo kushedi se çfarë. Mos kujto se çfarë ke bërë”, më tha. Pastaj ai roman u botua dhe u prit shumë mirë nga publiku.

Pothuajse gjithë librat tuaj, që erdhën më pas, nisur edhe nga titujt, “**Bashkëshortët**”, “**Një grua nga Tirana**”, “**Kohë e pamjaftueshme**” duket se janë një autobiografi e juaja. A thua vallë kjo, mos do të thotë se Ju jeni frymëzuar nga realiteti, nga historitë e jetës suaj. Besoj se po...Ndoshta pak a shumë....

Është interesante te letërsia e Helena Kadaresë se është bazuar te historitë e saj personale. Por edhe vetë Ismail Kadare, ka futur jetën e tij personale, në disa libra biles edhe në ndonjë rast marrëdhënien me Helena Kadaresë, siç është te “**Përbindëshi**”, ku personazhi Ana, është vetë Helena, janë pra takimet e saj të para me Ismailin... Madje zgjodhi një fat tragjik për Anën, ku në fakt të gjitha Anat kanë një fat gati tragjik në veprën e tij, sikurse edhe tek “**Aksidenti**”.Por ai vetë nuk ka qenë koshient, sepse ia kanë

bërë këtë pyetje edhe shumë herë të tjera. Anën, e ka një personazh shumë të dashur, e ka përdorur shpesh si emër në libra.

- 44 -

Pyetja tjetër ka qenë për Helenën, a thua vallë u ka shqetësuar fakti që Ismaili, papritur ju bënte personazh, të atyre që shkruante? Helena përgjigjet se të them të drejtën nuk e quaja se isha personazh. Ky është një nder shumë i madh. Dhe në vetvete i ka thënë vetes se është dikush tjetër, jo unë. Po kur personazhet ishin femra të tjera sidomos ato të historive të tij të dashurisë, në Moskë, që ju pak nga pak i zbulonit...Në fakt me historitë por edhe jetën e tij në Moskë u njoha më herët, nga poezitë e tij, por edhe nga ditarët, që ia gjeja e lexoja te shtëpia e tij. Dhe si të thuash, u vaksinova për këtë pjesë. Ditari ishte i mbushur me **Juba, Tanja** dhe mendoja thotë Helena se si ishte e mundur që një njeri të donte gjithë këto femra.

Përfundimisht u vaksinova dhe nuk më bënte më përshtypje. Ai ma përsëriste shpesh “Ti po të duash edhe ik, se unë nuk kam ndërmend të martohem”. Unë ia ktheja “kush ka ndërmend të martohet me ty”. Helena përpiqeshte të duket sa më origjinale. Helena dukej se kishte sjellë jetën e saj përkrah një shkrimtari të madh në librin e saj “**Jetë e pamjaftueshme**”... Është një libër që Helena ka filluar ta hartoj qysh në vitin 1996, derisa ka qenë në Dubrovnik, një kohë pas luftës dhe dilemave të ndryshme, atëher kur Kadaresë nuk i kanë pëlqyer librat autobiografikë....

- 11. Struktura narrative dhe galeria e personazheve**
- 12. Figura e femrës në veprat e Helena Kadaresë**
- 13. Vërtetimi i hipotezave.....**
- 14. P ë r m b l e d h j e.....**
- 17. Përfundimi.....**
- 18. Literatura e shfrytëzuar.....**

H y r j e

Arsyeja pse kam vendosur që pikërisht nga lënda e letërsisë së sotme shqipe të zgjedh temën e magistraturës, ka qenë e thjeshtë, sepse çdo herë më kanë pëlqyer veprat e **Helena Kadaresë**, posaçërisht figura e femrës dhe roli që luan kjo në veprat e kësaj krijuesje, e në veçanti rëndësia dhe pesha e saj në jetën e përditshme. Kjo më është dukur mjaft tërheqëse sa për të qenë e vendosur që t'i hyj kësaj pune me përgjegjësi morale dhe profesionale. Qëllimi im për këtë temë të masterit ka qenë që njohuritë e fituara në fakultet, t'i thelloj edhe mëtej duke i paraqitur në formë të punimit të thelluar të magistraturës. Prandaj qëllimi i punimit është që të jetë i kuptueshëm për lexuesit, që ata të mund të bëjnë krahasime mes femrës dhe rolit që luan ajo në romanet e **Helena Kadaresë**. Duke më ndihmuar në masë të madhe romanet e kësaj autoreje si burime me të dhëna më të sigurta, si dhe nga materialet tjera në portale të ndryshme, arrita të përmbledh disa nga elementet kryesore që duhet të theksohen në temën e këtij punimi.

Kemi bindjen kemi arritur që, sado pak, në një masë modeste të përfshij pikat kryesore që lidhen me rolin që luan femra në romanet e **Helena Kadare**, që çdokush që e lexon ta kuptojë thelbin e tyre, e me këtë të arrij dhe unë qëllimin tim rreth këtij punimi. Si fjalë e parë, jam shumë e

lumtur që kam arritur në këtë pikë të studimeve dhe të kem rastin të punoj me vullnet tezën e magjistraturës, me të cilin edhe formalisht do të shënoj përfundimin e studimeve të mia në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

- 47 -

A b s t r a c t

The reason why I have chosen today's Albanian literature as my master thesis is simple, it is because I have always enjoyed the works of **Helena Kadare**, especially the women's image and the role she has in the works of this writer, and in particular her importance and significance in everyday life. This seemed to me quite attractive as to be determined to get into such work with moral and professional responsibility. My aim for this master thesis was to widen my knowledge which I gained in college by presenting it in a form of profound Mastersthesis. Therefore the aim of this thesis is to be as clear as possible for the readers, so they can be able to make a comparison between women and the role she plays in the novels of **Helena Kadare**.

By helping me to a large extent as sources with more secure data, this author's novels, as well as materials from other different portals, i managed to summarize some of the key elements that should be emphasized in this thesis. I believe I have achieved, however little, in a modest way, to include the main points related to the role of women in the novels of **Helena Kadare**, that anyone who reads it to be able to understand their essence, and

thus to achieve my goal on this work. As first, I am very happy to reach this point of my research and to have the chance to willfully work this Master thesis, with which I will formally mark the completion of my studies in the branch of Albanian Language and Literature.

- 48 -

3. Motivimi dhe qëllimi i hulumtimit

Në kuadër të këtij punimi do të përpiqem të tërheq një paralele midis stilit të shkruar e të shprehur të autores së njohur Helena Kadare, e cila me botimin e romaneve të saj, paraqet një nga krijimet kulmore të saj në letërsinë tonë dhe më gjerë. Motivi **fillestar** i cili **më** ka detyruar për **të zgjedhur këtë** temë ka qenë vetë **Helena Kadare** e cila pa dyshim radhitet ndër krijueset letrare mjaft të rëndësishme të letërsisë bashkëkohore shqiptare. **Si e tillë paraqet** një muze **të** gjallë tipik të popullit shqiptar, me krijimtarinë e **saj** sasiore **dhe** të pashtershme është një femër dhe krijuese e mençur. Që nga vitet gjashtëdhjetë marret me krijimtari letrare. Shkruan kryesisht prozë për të rritur, e herë pas here edhe për fëmijë. Ka botuar shumë tregime, novela dhe romane. Gjithashtu, si qëllim i punimit është të hulumtoj se çka e motivoi Helena Kadarenë, të bëjë një rrugëtim të gjatë që i karakterizojnë veprat e saj, duke aluduar në ngjarjet që zhvillohen brenda tekstit, konstruktet brenda dialogut, botës së rrëfimit dhe pikepamjes estetike të saj.

Rëndësia e këtij punimi është se kemi të bëjmë me një vepër madhore të letrave shqipe, që kanë për autore një nga figurat e shquara të letërsisë tonë

Helena Kadarenë, të cilën lexuesit dhe kritika letrare shqiptare e njohin si njërin ndër krijueset më të njohura.

- 49 -

4. Lënda e hulumtimit:

Rëndësia e këtij studimi hulumtues shkencor ka për objekt analize letrare femrën në veprat e Helena Kadaresë. Kjo është një temë që kërkon një hulumtim gjithpërfshirës nga aspekti letrar, shoqëror, moral, edukativ dhe njerëzor. Pra, bëhet fjalë për rëndësinë e femrës në disa vepra të kësaj krijueseje në letërsinë shqiptare. Është kënaqësi e vaçant të merresh me artin letrar të saj, në të cilin shfaqet një përditshmëri me ndodhi të zakonshme. Jetësimi i krijimtarisë artistike të Helena Kadaresë çdo herë e bën të veçantë figurën e femrës duke i dhënë asaj sensin artistik të një cilësie të lartë. Krijuesja e shtyrë nga ky motiv do tu jap femrave vendin e merituar dhe të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare, sidomos kur ato ndjehen të pasigurta, të kërcënuara dhe të pambrojtura. Ato nuk e duan dhe nuk e meritojnë këtë mënyrë të jetesës, por fati i sjell në pozita inferiore, nuk kanë nga t'ia mbajnë dhe e vetmja gjë është t'u nënshtrohen fateve që ua sjell jeta dhe rrethi shoqëror. Ndoshta ky është shkaku që **Helena Kadare** shkruan për gra të barabarta me burrin në çdo aspekt të jetës, por edhe për gra fatzeza që e kalojnë jetën në skëterrë. Helena Kadare është çliruar me anë të shkrimit nga

kjo brengë që ia rënqeth trupin, prandaj rolin që luajnë femrat në veprat e saj nuk i lë pa i shfaqur si të tilla. Ajo në disa vepra të saj do të thotë se çdo gjë e ka rëndësinë e vet dhe secila prej tyre e ka vendin që e meriton në shoqërinë shqiptare.

- 50 -

Prandaj Helena Kadare i kushton një rëndësi të veçantë rolit të gruas që e paraqet në veprat e saj, për të cilat mund të themi se janë një himn për gratë, sepse ajo në gjithë krijimtarinë e saj ato i paraqet me gjithë virtytet e tyre duke u nisur nga ato më të larta deri tek ato më të ndërlikuara. Krijuesja i kushton rëndësi çdo gjëje që e përjeton femra, duke e paraqitur rolin e tyre vendimtar në të gjitha fushat. Krijuesja i kushton rëndësi çdo gjëje që e përjeton femra, duke e paraqitur rolin e tyre vendimtar në të gjitha fushat. Helena Kadare di të përshkruaj çdo gjendje shpirtërore që kalon femra, shqiptare duke u bazuar në ndjenjat e saj morale dhe njerëzore.

Siç duket Helena Kadare e ka sjellë jetën e saj përkrah një shkrimtari të madh në **“Jetë e pamjaftueshme”**...Një libër që kjo krijuese ka filluar tashkruaj në vitin 1996 ndërsa kishte qenë në Dubrovnik kohë pas luftës dhe dilemave të ndryshme, pasi Kadaresë nuk i pëlqenin librat autobiografikë....Duket se Kadare i ka sugjeruar Helenës se “në qoftë se duhet të shkruash diçka, duhet ta shkruash në mënyrë të tillë që ta pëlqejnë ballkanasit, sepse ata vetë, i shpërdorojnë këto gjëra dhe më tepër janë

narrativë. Ti je në gjendje ta bësh këtë gjë?”. “Besoj se po”, i thotë Helena. “Atëherë, nëse do që ky libër të jetë me vlera, duhet t’i thuash gjërat, ekzakt, ashtu siç kanë ndodhur dhe si ti i ke menduar. Ndodhitë duhet t’i thuash pa tabu. Mos u ndiko, as nga unë as nga ndokush tjetër”. Kjo më dha mundësinë e mirë që t’i shkruaja historitë pa droje. Ai më ka mësuar të shkruaj gjithmonë atë që mendoj, pa bërë dredha, sepse lexuesi ka një ndjeshmëri të jashtëzakonshëm, që e kap përnjëherë, kur përpiqesh të rrotullosh historinë, për të fshehur diçka.

- 51 -

6. Metodologjia e hulumtimit

Në bazë të qëllimit të punimit, metodologjia e kërkimit do të mbështetet në veprat e **Helena Kadaresë**, duke sqaruar më hollësisht ngjarjet nga jeta e saj dhe dukuritë e ndryshme që i paraqiten brenda rrugës së saj si romanciere.

Romanet analizohen secili në veçanti deridsa arrihet përfundimi. Veprat prozaike analizohen secila në veçanti dhe arrihet përfundimi për të kuptuar se **Helena Kadare** është njëra ndër krijueset më të shquara të letërsisë tonë. Ditët për një të ardhme më të mire, besimi dhe entuziazmi i njeriut shqiptar do të buzëqeshë drejt së nesërme që hanë temë frymëzimi në veprat e Helena Kadaresë. Pothuajse të gjithë librat e Helena Kadaresë, të cilët kanë ardhur më pas, duke filluar nga titujt, “**Bashkëshortët**”, “**Një**

grua nga Tirana”, “Kohë e pamjaftueshme” na duken sikur janë një autobiografi të kësaj krijuesje letrare.

Kjo ka mundësi që Helena Kadare është frymëzuar nga realiteti dhe nga historitë e jetës së saj. Është mjaft **interesante te letërsia e saj** se kjo krijuese është mbështetur thjesht në historinë personale të saj. Por edhe vetë Ismail Kadare, ka futur jetën e tij personale, në disa libra biles edhe në ndonjë rast marrëdhënien me **Helena Kadarenë**, siç është te **“Përbindëshi”**, ku vetë personazhi Ana, është në realitet Helena, pra janë takimet fillestare të saj me Ismail Kadarenë... Madje do të zgjedhë një fat tragjik për Anën. ... Dhe në fakt të gjitha Anat kanë një fat gati tragjik në veprën e tij, sikurse edhe tek **“Aksidenti”**.

- 52 -

Por Helena Kadare duket se nuk ka qenë koshient, për arsye se ia kanë bërë këtë pyetje edhe shumë herë të tjera. Për këtë arsye “Anën”, në të vërtetë Helenën e ka pasur një personazh shumë të dashur, duke e përdorur shpeshherë si emër në librat e tij. Por Helenën nuk e ka shqetësuar aspak e vërteta që Kadare, fare papritur e kishte bërë personazh të disa nga veprat të cilat i hartonte... Por Helena nuk e ka quajtur se ka qenë protagoniste. Përkundrazi do të thotë ajo se ka qenë për këtë një nder mjaftë i madh. Porse thënë në të vërtetë nuk e ka quajtur se kishte qenë ajo vetë personazhi. Përkundrazi kjo një gjë të tillë e quan si një nder shumë i madh. Gjithmon i ka thënë vetes se ka qenë ndonjë tjetër, e jo kjo. Po kur personazhet ishin

femra të tjera sidomos ato të historive të tij të dashurisë, në Moskë, që ju pak nga pak i zbulonit...Në fakt me historitë por edhe jetën e tij në Moskë u njoha më herët, nga poezitë e tij, por edhe nga ditarët, që ia gjeja e lexoja te shtëpia e tij. Dhe si të thuash, u vaksinova për këtë pjesë. Ditari ishte i mbushur me Juba, Tanja etj. Dhe mendoja se si ishte e mundur që një njeri të donte gjithë këto femra. Përfundimisht. U vaksinova dhe nuk më bënte më përshtypje. Ai ma përsëriste shpesh “ti po të duash edhe ik, se unë nuk kam ndërmend të martohem”. Unë ia ktheja “kush ka ndërmend të martohet me ty”. Përpiqesha të dukesh sa më origjinale.

- 53 -

Ajo e ka sjellë jetën e saj përkrah një shkrimtari të madh në librin **“Jetë e pamjaftueshme”**... Një libër që keni nisur ta shkruani në vitin 1996 ndërsa ishit në Dubrovnik kohë pas luftës dhe dilemave të ndryshme, pasi Kadaresë nuk i pëlqenin librat autobiografikë.... **Helena Kadare** në një rast do të rrëfëhet duke thënë se: Momenti ynë më i keq në jetë është kur e lashë letërsinë duke besuar te letërsia e madhe e **Kadaresë**...Momenti më i keq në jetën tonë ka qenë debati për poemën **"Në mesditë"** kur u mbledh byroja politike.

7. Hipotezat e hulumtimit:

Lidhur me këtë hulumtim do të merren parasysh hipotezat e mëposhtme:

Ka një lidhje të ngushtë midis veprave të **Helena** Kadaresë ku në plan të parë ndeshim personazhin kryesor femër dhe në veprat tjera mund të jetë personazh dytësor.

Ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes figurave pozitive dhe atyre negative

Te disa vepra kjo krijuese zbulon aspektet kompozicionale dhe krijuese të punës dhe jetës së tyre.

8. Letërsia bashkëkohore shqiptare

Gjatë këtij hulumtimi shkencor i kam përdorur metodat më të përshtatshme që i përgjigjen temës dhe veprave të kësaj autoreje të spikatur, me qëllim që të arrijm gjer tek njohuritë që i kemi synimin kryesor për t'i realizuar, pasi që përdorimi i sakt i metodave ndikon në ndërthurjen dhe shpjegimin e sakt të këtij punimi shkencor. Ky hulumtim do të realizohet përmes zbatimit të analizës së kritikës tekstuale dhe krahasimeve letrare, artistike dhe

gjuhësore. Në mënyrë të veçantë do të shfrytëzohen burimet relevante të cilat i kemi në dispozicion për studimin dhe analizën letrare të veprave të kësaj autoreje të njohur, siç janë: **"Bashkëshortët"**, **"Kohë e pamjaftueshme"**, **"Një lindje e vështirë"**, **"Një grua nga Tirana"** dhe krijimet tjera të korpusit të veprave të kësaj krijuesje, duke i komentuar mbi masën dhe thellësinë e ndryshimeve të bëra nga kjo autore. Lidhur me romanin e parë të saj ajo do të thotë se pas atij udhëtimi unë kam shkruar një sërë tregimesh, që kishin të bënin me Kosovën.

- 56 -

Një roman ky i shkruar në vitet '70 i cili u prit shumë mirë nga publiku. Pothuajse gjithë librat e saj, që erdhën më pas, nisur edhe nga titujt, **"Bashkëshortët"**, **"Një grua nga Tirana"**, **"Kohë e pamjaftueshme"** duket sikur janë një autobiografi e saj. Kjo, mos do të thotë se Helena Kadare është frymëzuar nga realiteti dhe nga historitë e jetës së saj.

Vepra **"Një grua nga Tirana"** i krijueses së njohur **Helena Kadare** që u shtyp nga Shtypshkronja botuese **"Onufri"**. Bulevardi **"Dëshmorët e**

Kombit” qe mbushur me djemtë e vajzat e Fakultetit të Inxhinierisë, që po zbrisnin nga godina e rektoratit. Asaj iu kujtua vetja kur ishte si ato dhe kishte bërë dashuri për herë të parë. Romani **"Një grua nga Tirana"** është nisur në Tiranë dhe me një distancë kohore , e ka përfunduar në Paris.

Ky roman vjen nga një metropol i njohur në të cilin do të hartohet arti i madh, por ku nuk do të mungojnë në përmasa të dukshme as dështimet dhe eksperimentet letrare boshe. Kush ndodhet mes të mëdhenjve dhe boshllëkut, shpesh rrezikon qoftë dhe për modë ta shpartallojë veten. Kjo autore duket se vjen sërish si një ledi serioze, andaj kjo autore duket se e ka ruajtur individualitetin e saj duke qenë kështu sërish merita e parë e kësaj krijesje të artit letrar. Helena Kadare duket se është zhvilluar brenda këtij individualiteti dhe një çështje e këtillë është sërish merita shquese e kësaj artisteje.

- 56 -

Helena Kadare është një krijuese letrare e veçant e cila e ka dashur gjithmonë klasiken, klasiken që plekset pa bujë të madhe me modernen. Në këtë drejtim ne e vërejmë gjithashtu zhvillimin e arritur të saj, e cila ka vazhduar kah njëloj kultivimi qelizor të prozës së saj. Duket se kjo autore ka qenë në njëfarë orvatjeje duke i faktozuar një një mënyrë të gjitha elementet e veprës duke arritur këssoj, mundësisht në çdo faqe të kësaj vepre një estetizim të tërësishëm të brendisë së romanit.

Pothuajse nuk ka krijuese e nuk e ka të qartë se gjer ku do ta shpie rruga e zgjedhur, porse nuk është e vështirë të kuptohet se sa dhe çfarë investon kjo gjatë kësaj rruge. Në veprën **"Një grua nga Tirana"** Helena

Kadare ka investuar pa ndonjë rezervë , por edhe pa u ngutur. Sikurse një krijuese e sensit, që është i lindur gjithashtu njëkohësisht i mprehur vazhdimisht, duket sikur edhe rrëfimin të cilin ia ka besuar më tepër intuitës, ndërsa dialogun ia kishte besuar më tepër situatës, gjithashtu përshkrimin dhe koloritin e spikatur qytetar.

- 57 -

Anët e saj më të forta, ia kishte besuar veçanërisht talentit, herë-herë i kishte kapërcyer përmes kësaj vizores së shkallëzuar, të cilën me kohë ia ka dhënë kultura e asimiluar dhe përvoja prej artisti, me dëshirën e mirë në të cilën sikur të mungonte diç , të paktën asgjë të mos ishte e tepërt. Kemi bindjen se kjo lojë e imtë dhe e mundimshme me fjalën, të cilën për shumëkënd mund të kishte kapërcyer pa e vështruar, duket se mund të jetë njëra nga betejat e fituara brenda këtij akti të gjatë artistik.

Por nëse kjo vepër romanore i ka marrë kësaj autoreje më shumë energji prej sa kishte pandehur, po ashtu sikur ndoshta akoma nuk ia kishte

kthyer kënaqësinë të cilën e meriton, një gjë e këtillë ka qenë njëkohësisht vepër e djallit. Ndonjëherë, më duket se përderisa ishte përzënë fillimisht nga viset qiellore, djalli kishte rënë në vendin tonë dhe kishte mbetur midis nesh. Një gjë e këtillë do të thotë se ne sërish lypset të kemi kujdes, për arsye se njëmend njerëzit tani mund të qeshin dhe të qajnë për vete, por këta prishen njësoj kur harrojnë të gëzojnë ndaj të tjerëve.

Te kjo Tirana jonë, sikurse e kishte thënë sërish, apo bëhet fjalë pa lexuar, apo lexohet dhe nuk flitet. Andaj prej këtu fillon gjithashtu njëfarë lëçitje tjetër e "**Një gruaje nga Tirana**", është vepra më e re i prozës më të arrirë të Helena Kadaresë. Kjo lidhur me njerëzit do të thotë se: Kam nxjerrë dhe një përfundim të përgjithshëm për njerëzit: Kurrë nuk janë njerëzit ashtu siç duken. Këtu, por edhe atje te ne...

- 58 -

Duhet t'i njohësh ata nga afër, të kesh kontakte në vende dhe në rrethana të ndryshme, për të nxjerrë konkluzione të sakta, por që edhe ato, nuk janë përherë të pagabueshme. Ajo ka një këmbëngulje të pabesueshme e të palodhur për t'i çuar gjërat përpara. Në këtë mënyrë ka synuar ta krijonte vetë profilin e saj. Kjo krijuese ka një aftësi të çuditshme duke të mbushur mendjen edhe kur s'je i një mendjeje me të. Përgjatë gjithë rrëfimit në veprat e saj, Helena Kadare është shoqëruar edhe me vështrime lexuesish që gjenin tek ajo jo vetëm shkrimtaren, por edhe gruan që me modelin e saj ka emancipuar e frymëzuar gratë shqiptare.

Helena Kadare lidhur me **Kosovën** do të thotë se asgjë nga udhëtimet

e mia të mëvonshme nëpër botë, nuk e arrin atë lumturi të atij udhëtimi të parë në Kosovë. Pas atij udhëtimi unë kam shkruar një sërë tregimesh, që kishin të bënin me Kosovën.

- 59 -

5. Rëndësia e punimit:

Rëndësia e kësaj teze të hulumtimit shtrihet në tematikën dhe përmbajtjen e cila ka të bëjë me subjektin letrar dhe ideoartistik. Kjo tezë është orientuar në përvijimin e këndvështrimit personal të autores dhe personazheve të veprave në fjalë, në të cilat **Helena** Kadare i ka dhënë burimet e tyre kryesore, të cilat çuan në krijimin e dy tragjedi të mëdha të periudhës elizabetiane. Kjo tezë ka për qëllim të vë në pah zhvillimin e diferencave dhe pikësnyimeve të figurave kryesore: në rastin e personazheve femra në disa aspekte në një mjedis të zakonshëm shqiptar. Prirja e **Helena** Kadaresë për t'i dhënë krijimtarisë së saj letrare një kuptim filozofik, në të cilin kërkon dhe e gjen shpjegimin për

misterin e jetës në mes të realitetit dhe fikSIONIT. Ky vision do të jetë një analizë e qëllimeve, ku zbulohen ëndërrat e zemrës femërore që i përngjajnë kohës e cila ecën si ania nëpër jetë.

Pas një analize të plotë të faktorëve të përmendur më sipër, kjo punë hulumtuese letrare lind vetvetiu përmes një informacioni më të detajuar dhe specifik në lidhje me vepra të cilët kanë objekt pasqyrimi femrën shqiptare në një shoqëri monizmi me plot peripeci, dilemash dhe misteresh. Veprat e **Helena** Kadaresë vetvetiu sikur na japin njohuri për atë që është mënyra më e mirë për të kuptuar femrën si grua, bashkëshorte, nëpunëse dhe intelektuale. Në një situatë të tillë edhe dashuria nuk është një urë shpëtimi, sepse edhe kjo vetë është diçka kalimtare, është si një gotë me ujë që avullon. Qëllimi i metodologjisë së hulumtimit është që të sigurojë dëshmi që do të testojnë dhe mbështesin, apo mohojnë hipotezat. Të dy metodat, ajo kualitative dhe kuantitative të hulumtimit do të përdoren në mikrotezë.

- 60 -

6. Strukturimi i punimit:

Për të nxitur interesimin e lexuesve duhet bërë një strukturë të qartë të punimit, prandaj është e nevojshme që ne si studiues të rinjë të mendohemi që brenda mundësive tona të hartojmë një punim me vlerë të duhur dhe të mundshme. Andaj ky studim letrar paraqet një punë serioze dhe të mirëfilltë shkencore, i cili trajton tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me figurën e femrës në veprat e shkrimtares sonë Helena Kadaresë. Për këtë arsye konsiderojmë se element i rëndësishëm i çdo punimi është struktura e tij. Që të bëjmë një strukturë të mirëfilltë së pari na duhen njohuri të përgjithshme në lidhje me temën. Qëllimi ynë është që të paraqesim personazhin femër në romanet e **Helena** Kadaresë. Personazhi, bashkë me kohën-hapësirën, është kategori themelore e llojeve

tregimtare në letërsinë tonë. Ai, zakonisht është zëdhënës kryesor i shkrimtares. Përmes tij përcaktohet dhe manifestohet ndërgjegjja individuale dhe kolektive, në të cilën shprehet këndvështrimi dhe perspektiva jetësore. Kur personazhi ngrihet në rrafsh reprezentues, shpreh dhe përcakton jo vetëm ndërgjegjen e kohës, por paralajmëron njëkohësisht edhe atë vizion dhe ndjesi që sapo fillon të duket se ka lindur në horizont. Përmes tij bëhet edhe hulumtimi i shumë breznive. Hulumtimi ynë mbi rolin e gruas në romanet e **Helena Kadaresë** është punim shumë i rëndësishëm i cili pa dyshim paraqet vlera të mëdha, sepse çdo roman i kësaj autoreje është një histori më vete, dhe çdo lexues shumë shpejt krijon një përshtypje dhe interesim të jashtëzakonshëm për krijimtarinë e **Helena Kadaresë**. Të gjitha veprat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën sepse paraqesin jetën reale. Mënyra këndvështruese në romanet e **Helena Kadaresë** është shumë e vaçantë. **Për këtë arsye** nuk kemi dyshim se shkrimtarja trashëgon vlerat më të mira të realizmit real. Pra, ai e paraqet fatin njerëzor dhe problemet ekzistenciale.

- 61 -

Helena Kadare i paraqet femrat si një faktor tepër të rëndësishëm për shoqërinë. Gruaja është një personalitet i përsosur, prandaj edhe autorja ia jep të gjitha të drejtat që përkojnë me natyrën e saj. Me një fjalë, ajo e mbështet figurën e gruas dhe i kushton vëmendje të madhe.

Për të kjo qenie ka vlera të mirëfillta në shoqëri, prandaj i paraqet gratë si nismëtare të ndryshimit shoqëror. Femra në përgjithësi ka qenë më pak e pranishme nëpër pozicionet ku ishte burri, por ajo, edhe pse është ndjerë e mënjanuar në këtë aspekt, femra gradualisht filloi t'i ketë rolet e ëndërruara, pavarësisht rrethanave në të cilat ka jetuar. Ajo ëndërron përsëri dhe, në të shumtën e rasteve, ëndrrat e saj janë të thjeshta dhe të pazakonta ashtu siç janë dhe rrethanat në të cilat ajo ëndërron.

Teza e masterit është e strukturuar në pesë pjesë, ku secila ka të bëjë me analizën e figurës së femrës në romane, dhe rolin e saj që luan në to. Duke bërë krahasimin në mes romaneve se çfarë rëndësie ka femra në krimtarinë e **Helena Kadaresë**, pra stuktura në vijim mund të jetë një pikë e mirë filluese për strukturimin e këtij punimi.

- 62 -

9. Përfundimi:

Në këtë punim trajtohet figura e femrës në romanet e **Helena Kadaresë**, ku si pikë kyçe është roli i saj në veprat e kësaj krijuesje. Për mua është një kënaqësi e veçant të lexoj veprat e **Helena Kadaresë** dhe të flas për gruan që është shumë e pranishme në romanet e saj. Shkrimtarja duke e përshkruar figurën e gruas i jep **asaj** vendin e merituar në shoqërinë shqiptare. Kjo tregon qartë se ajo e njeh mirë realitetin e kohës, ndaj e përshkruan aq bukur figurën e grave, sa në momente të vjen se je prezent aty dhe e shikon ngjarjen nga afër. **Helena** Kadare nuk harron ta përshkruaj pamjen e saj dhe për të sajton shumë epitete të bukura. Femra paraqitet e pacënueshme, ndërsa në disa nga romanet e saj ajo del e shtypur në familje dhe në shoqëri, pa

asnjë lloj autoriteti, pa dinjitet dhe tepër e përbuzur. Me një fjalë, romanet e **Helena Kadaresë** janë plot copëza të jetës së vërtetë. Jeta e femrave është shumë interesante. Secila prej tyre ka personalitetin e vet, është një femër tekanoze dhe e pavarur e cila e bën romanin më tërheqës për lexuesit. Këto femra janë të veçanta dhe ndryshojnë shumë për nga karakteri. Thjesht, secila prej tyre **paraqet një** botë më vete. **Helena Kadare** e përshkruan bukurinë femërore duke i idealizuar veçoritë dhe virtytet e saj. Edhe pse bukurinë e një gruaje e shfaq vetëm në një skicë, në të cilën është karakteri ai që e bën një femër të jetë kryevepër në vete. Këtë gjë ajo e bën në mënyrë të përkryer, duke u munduar që, përmes kësaj figure, t'i shfaqë qëndrimet e veta për jetën e njeriut në përgjithësi.

- 63 -

Prandaj, grujat në romanet e **Helena Kadaresë** paraqiten si intelektuale që është në gjendje të formësojë preokupimet e veta dhe të luftojë për to. Shumë personazhe **femra** që i hasim në veprat e saj, i kundërvihen realitetit me jetën që e ndërtojnë. Përmes **figurës së gruas**, **Helena Kadare** në veprat e **saj** vazhdon betejën morale për emancipimin e **gruas**. Ajo është e lidhur ngushtë me rrethin dhe kohën në të cilën jeton. Shkrimtarja e bën **personazhin femër** të flasë për fuqinë e gruas që është në gjendje t'i kundërvihet së keqes.

Në shumë romane shkrimtarja dëshmon kujdesin e madh që ka ndaj rolit që luan femra në jetë. Duke e ngritur **atë** në një nivel mirësie dhe bukurie, ajo mundohet që t'i shmanget së keqes që e rrethon. Figura e gruas sipas **Helena Kadaresë** jeton në periferi të jetës. Fati që e përcjell gruan nuk është i përcaktuar nga përkatësia e klasave, sepse tragjikën e jetës e ndienë njëjtë si femra e varfër ashtu edhe e pasura. Ajo shfaqet me ëndërra të parrealizuara, e cila e kupton jetën si dështim. Në veprat e **Helena Kadaresë** vend të veçantë zë edhe dashuria e **femrës**, e cila mbretëron si kuptim i përjetësisë.

Kjo dukuri është fuqi që shkatërron çdo gjë para vetes dhe e vetmja që i bën ballë kësaj fuqie është femra. Jeta, qoftë si nocion filozofik apo real, për **Helena Kadare** ka kuptim vetëm nëse në të bën pjesë femra si simbol i dashurisë dhe bukurisë.

- 64 -

Me përmbajtjen e veprave të saj, kjo shkrimtare i nxjerr në pah të gjitha të metat e shoqërisë. Gruaja në romanet e saj del e shtypur dhe pa botën e saj të pavarur. Me të manipulon edhe shoqëria edhe familja. Ajo është e tjetërsuar dhe e përbuzur dhe herë-herë vihet në shërbim të së keqes nga e cila së pari e pëson vetë. Autorja këto probleme i shfaq në vepra me qëllim, që shoqëria t'i luftojë padrejtësitë që i bëhen gruas, me shpresë se një ditë do të mund ta shijojnë triumfin e fitores.

Figurës së gruas Helena Kadare i kushton rol shumë të rëndësishëm. Ajo është një treguese e përgjithshme e vuajtjeve njerëzore. Në disa shkrime ajo del në një gjendje që nuk mund ta jetojë as rininë e saj. Në

këtë mënyrë femra ka për qëllim të demaskojë mendimin prapanik viktimë e të cilit është vetë ajo. Dhembjen e këtyre femrave nuk e sheh askush, sepse çdonjëri mundohet t'i harrojë ato sa më shpejt. Sepse këto femra do t'u ngjallnin atyre përdëllim të cilin ata nuk ia dëshirojnë vetes. Si gjithë femrat e tjera edhe ata e duan jetën, prandaj durimi i tyre është i madh, ashtu si dashuria që ka për jetën. Ajo i bën ballë çdo gjëje dhe e duron edhe barrën që i rëndon mbi kurriz, vetëm që të ketë jetë të qetë dhe të gjejë lumturinë. Këto femra ndiejnë vetmi të madhe nga që hidhen në krahët e atyre që nuk meritojnë. Duke ua dhuruar shpirtin të tillëve, ato qëndrojnë të heshtura përballë një dhembjeje të madhe. Ata shpesh qeshin dhe shfaqen të lumtura, ndërkohë që zemra u qan. Figura e femrës është paraqitur me të gjitha virtytet e gruas së zakonshme. Ajo di ta tregojë karakterin e gruas besnike, e cila është *qenie* delikate, e ndjeshme dhe me plot ëndërra për *jetën*, është një heroinë dhembshurie.

- 65 -

Elena Kadare gjithashtu e njohur edhe si **Elena Gushi-Kadare**, lindi në vitin 1943 në Elbasan. Është një ndër të paktat shkrimtare romanciere shqiptare, në vitet e regjimit komunist. Autore e shtatë vëllimeve, veprat e saj flasin për ëndërrimet vajzërore, përjetimet e të qenit nënë dhe bashkëshorte.

Gjithashtu është një përkthyes cilësorë e disa veprave të autorëve të njohur botërorë, kryesisht francez. Helena është bashkëshortja e autorit të famshëm shqiptar, Ismail Kadare. Së fundmi është botuar nga Sh.B. Onufri libri biografik "**Kohë e pamjaftueshme**", në të cilin rrëfen gjerësisht bashkëjetesën e saj me Kadarenë.

Veprat tjera të saj janë: "**Një lindje e vështirë**" - roman, 1970, "**Një grua nga Tirana**" - roman, Onufri, 2000, "**Bashkëshortët**" - roman, 2002.

- 66 -

Rrëfimi i Helena Kadare: Momenti ynë më i keq në jetë

E lashë letërsinë duke besuar te letërsia e madhe e **Kadaresë**... Momenti më i keq në jetën tonë ka qenë debati për poemën ‘**Në mesditë**’ kur u mbledh byroja politike”. **Helena Kadare** është në “**Sonder**” në Prishtinë e ftuar të flasë për letërsinë e saj dhe jetën e saj pranë shkrimtarit Ismail Kadare. Ajo ka qenë për herë të parë **Helena Kadare** atje në një rrëfim për letërsinë dhe jetën si bashkëshorte e shkrimtarit të madh para lexuesit të Kosovës. E vënë përballë gazetareve Beti Njuma dhe Alda Bardhyli, ajo bëri një rrëfim të rrallë mbi udhëtimin e pazakontë të një gruaje në letërsi. Në historinë e letërsisë shqipe **Helena Kadare** hyn tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin

1970-të me romanin e parë **“Një lindje e vështirë” I shkruar në ’70**. Libri u prit mirë nga kritika. Është pothuajse gruaja e parë që shkroi një roman. Më pas ajo rikthehet për lexuesin në fillim të viteve ‘90-të me romanin **“Një grua nga Tirana”**, gjithashtu dhe **“Bashkëshortët”**, në vitin 2002. Me një stil të veçantë rrëfimet e **Helenës** janë përshkruar nga një ndjeshmëri i hollë. Në Prishtinë tregoi se “në Kosovë kam qenë për herë të parë në një delegacion të Lidhjes së Shkrimtarëve të kryesuar nga Dritëro Agolli. Një vit më pas erdha me Ismailin. Kur erdha me të, vaska e hotelit ishte e mbushur me lule nga adhuruesit e tij, megjithatë më thanë se në Hotel Grand kishte përgjues”, - kujton ajo vite më pas. **Helena** ka një kontribut të konsiderueshëm në fushën e përkthimeve, mjaft të kujtojmë për shembull **“Tri gratë”** e japonezit Isushi Inoe apo **“Një grua në Berlin”** ditar i një autoreje anonime, gjermane, që përshkruan javët nga 20 prilli gjer në qershor të vitit 1945.

- 67 -

Helena Kadare thotë se “Letërsia është një histori dashurie dhe fati i përzjer bashkë, një përshkrim i uraganit të çmendur të pasioneve të njeriut dhe i luftës që ai bën me to...”. **Helena Kadare** ka mundur t’i japë këtij shkrimtari të madh të letërsisë botërore jetë në gjuhën shqipe, duke shqipëruar dy nga veprat e tij më të rëndësishme si **“Dashuri e vonë”** apo **“Shosha”**.

Me një aftësi për të përshkruar gjithë dimensionin e ndjeshmërisë së këtij shkrimtari, ajo e ka bërë veprën e **Singer-it** të paharrueshme në shqip. Ndërsa **“Shosha”** është një nga romanet që ajo rekomandon për të lexuar në listën prej 10 librash që nuk duhen humbur. Një krijim krejt original jashtë çdo norme, një personazh pa ndonjë cilësi të veçantë apo të

jashtëzakonshme, por mbresëlënëse në llojin e vet. Ka në të një mirësi të ëmbël, kokëfortësi gjithashtu, marrëzi dhe tuhafllek sa të duash, dhe plot detaje të të gjitha ngjyrave, që çuditërisht e bëjnë atë një personazh të paharrueshëm radhisim 10 librat që **Helena Kadare**, i sugjeron për lexuesit e “**Mapo Letrare**”...

- 68 -

I ardhur në shqip nën përkthimin e **Helena Kadaresë**, libri është quajtur nga kritika si “Bizhuja e letërsisë së dashurisë”. Ndërsa te “**Mëngjese në kafe Rostand**”, **Ismail Kadare** paraqet “Idenë për të shkruar diçka për Kafe Rostand e cila i kishte ardhur aq natyrshëm, sa që s’e kishte mbajtur mend as kohën dhe as rrethanat. Ishte një ndjesi midis pendimit dhe mirënjohjes, e ngjashme me atë ndaj shoqes së jetës, që duke qenë pranë teje në gjithçka, nuk e ka pasur, ose ty të duket se nuk e ka pasur, vëmendjen e duhur. Në këtë kafe kisha shkruar qindra faqe dhe po aq shënime për motive

e sinopse, pa u kujtuar asnjëherë për atë vetë, kafenenë...”, shkruan vetë Kadare mbi këtë libër. Një përmbledhje esesh dhe shënimesh autobiografike të shkruara në kafenenë ku ndan pjesën më të madhe të kohës në Paris. Me një mençuri të një lloji të veçantë, me një logjikë fëminore, Shosha i di mësë miri gjërat më thelbësore të jetës, i kupton dhe i pranon ato. Libri ka ardhur në shqip nën shqipërimin e **Helena Kadaresë**.

- 69 -

Përmbyllje

Ky punim kishte për objekt njohjen, leximin dhe analizën e veprimtarisë letrare të **Helena Kadare**. Duke qenë monografi e parë e kësaj natyre për krijimtarinë e saj, në **përqëndrimin tonë** janë **vënë romanet e kësaj krijesje të njohur në letërsinë tonë me romanet "Një lindje e vështirë", Novelë, 1970, "Një grua nga Tirana", Novelë, 1990, "Bashkëshortët", Onufri 2002, "Kohë e pamjaftueshme", 2011 e tjerë** , fillimisht **Helena Kadare** është parë në planin kontekstual në

dimensione të ndryshme, atë: familjar, intelektual, kulturor dhe politik. Duke e vërejtur se lexuesi dhe kritika ka qëndrime të larmishme ndaj figurës së kësaj krijuesje, duke filluar nga romanet dhe krijimtaria e saj, ndaj jetës dhe veprimtarisë letrare, jemi munduar që, për lexuesin e sotëm dhe atë të ardhshëm të saj, të provojmë argumentin se **Helena Kadare** përveç që është letrare dhe krijuese e njohur, e dashur dhe e respektuar nga intelektualët dhe personalitetet e kohës. Po ashtu është me rëndësi të përmendim se portreti për **Helena Kadarenë** nuk është vetëm biografi por kontekst objektiv sepse për të nuk mund të shkruhet thjeshtë vetëm si krijuese. Në pjesën e parë dhe të dytë të punimit janë vënë në pah veprat letrare të saj që i kemi analizuar dhe të cilat mbështeten në teori të ndryshme bashkëkohore. Metoda kryesore e përdorur në shqyrtimin dhe leximin e veprave letrare të kësaj krijuesje të njohur është ajo e analizës së tekstit të veprave të saj në rrafshe të ndryshme interpretimi.

- 70 -

Në vazhdim japim përfundimet e arritura për veprën letrare të kësaj autoreje të njohur. Romani "**Një lindje e vështirë**". "**Kohë e pamjaftueshme**", kujtime me Autoren **Helena Kadare**. Shtëpia botuese: Onufri. Viti i botimit 2011. Duke qenë edhe ajo shkrimtare, bashkëshortja e Ismail Kadaresë, **Helena**, zbulon fatin e një çifti të pazakontë.

Në këtë rrëfim të mbushur plot ngjarje që dalin dhe e kapërcejnë të zakonshmen e një jete të përbashkët, shpaloset aktualiteti i një gjysmë shekulli që ka parë apogjeun, dhe më pas, agoninë dhe fundin e regjimeve komuniste në Europën Lindore. Në rrethin e miqësive, takimeve, të fshehtave të përbashkëta, ky çift gjen energji dhe kurajë që të mposhtë

ankthin që diktatura ushtroi mbi banorët e vendit më të mbyllur dhe më misterioz në Europë.

Në këtë punim kemi analizuar dhe studiuar hap pas hapi krijimtarinë e **Helena Kadare** me metoda të ndryshme dhe në plane të shumta për të dhënë një monografi për autoren, që me të drejtë konsiderohet si shkrimtarja e parë shqiptare. Gjatë leximit të veprës së autores zbulojmë se krijimtaria e saj sa në dimensionin letrar po aq edhe në atë joletrar ka veçanti dhe vlera të spikatura. Larmia e madhe e formave të shkrimit, dëshmon për natyrën e saj kërkuese dhe njohëse të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

- 71 -

Në veprën e saj gjejmë gërshetimin më të mirë të përshkrimit të hollësishëm të botës së gruas, jetës së përditshme sociale, anët zakonore dhe rituale që krijojnë një tingëllim origjinal me zë unik në letrat shqipe. **Helena Kadare** është shkrimtare e talentuar e cila ka lënë gjurmë të përherëshme në letërsinë dhe në historinë shqiptare. Andaj në këtë vështrim letrar të saj jemi munduar të bëjmë një studim shterrues duke qenë të bindur se kemi dhënë një kontribut sado modest në njohjen, leximin dhe shqyrtimin e tutjeshëm të veprës së kësaj romanciereje. Me anë të përshkrimeve që bën, fare lehtë mund ta dallojmë se çfarë roli luan gruaja në roman, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra, sepse ajo e vlerëson figurën e gruas shumë lartë, duke e paraqitur atë si qenie të bukur. Femra paraqitet e pacënueshme, ndërsa në disa nga romanet e saj ajo del e shtypur në familje dhe

në shoqëri, pa asnjë lloj autoriteti, pa dinjitet dhe tepër e përbuzur. Me një fjalë, romanet e **Helena Kadaresë** janë plot copëza të jetës së vërtetë. Jeta e femrave është shumë interesante.

Secila prej tyre ka personalitetin e vet, është një femër tekanjoze dhe e pavarur e cila e bën romanin më tërheqës për lexuesit. Këto femra janë të veçanta dhe ndryshojnë shumë për nga karakteri. Thjesht, secila prej tyre **paraqet një** botë më vete.

- 72 -

Helena Kadare e përshkruan bukurinë femërore duke i idealizuar veçoritë dhe virtytet e saj. Edhe pse bukurinë e një gruaje e shfaq vetëm në një skicë, në të cilën është karakteri ai që e bën një femër të jetë kryevepër në vete. Këtë gjë ajo e bën në mënyrë të përkryer, duke u munduar që, përmes kësaj figure, t'i shfaqë qëndrimet e veta për jetën e njeriut në përgjithësi. Prandaj, gruaje në romanet e **Helena Kadaresë** paraqitet si intelektuale që është në gjendje të formësojë preokupimet e veta dhe të luftojë për to. Shumë personazhe **femra** që i hasim në veprat e **saj**, i kundërvihen realitetit me jetën që e ndërtojnë. Përmes figurës së gruas, **Helena Kadare** në veprat e **saj**

vazhdon betejën morale për emancipimin e **gruas**. Ajo është e lidhur ngushtë me rrethin dhe kohën në të cilën jeton.

Shkrimtarja e bën **personazhin femër** të flasë për fuqinë e gruas që është në gjendje t'i kundërvihet së keqes. Në shumë romane shkrimtarja dëshmon kujdesin e madh që ka ndaj rolit që luan femra në jetë. Duke e ngritur **atë** në një nivel mirësie dhe bukurie, ajo mundohet që t'i shmanget së keqes që e rrethon. Figura e gruas sipas **Helena Kadaresë** jeton në periferi të jetës. Fati që e përcjell gruan nuk është i përcaktuar nga përkatësia e klasave, sepse tragjikën e jetës e ndienë njëjtë si femra e varfër ashtu edhe e pasura. Ajo shfaqet me ëndërra të parealizuar, e cila e kupton jetën si dështim.

- 73 -

Në veprat e **Helena Kadaresë** vend të veçantë zë edhe dashuria e **femrës**, e cila mbretëron si kuptim i përjetësisë. Kjo dukuri është fuqi që shkatërron çdo gjë para vetes dhe e vetmja që i bën ballë kësaj fuqie është femra. Jeta, qoftë si nocion filozofik apo real, për **Helena Kadare** ka kuptim vetëm nëse në të bën pjesë femra si simbol i dashurisë dhe bukurisë. Me përmbajtjen e veprave të saj, kjo shkrimtare i nxjerr në pah të gjitha të metat e shoqërisë. Gruaja në romanet e saj del e shtypur dhe pa botën e saj të pavarur.

Me të manipulon edhe shoqëria edhe familja. Ajo është e tjetërsuar dhe e përbuzur dhe herë-herë vihet në shërbim të së keqës nga e cila së pari e pëson vetë. Autorja këto probleme i shfaq në vepra me qëllim, që shoqëria t'i luftojë

padrejtësitë që i bëhen gruas, me shpresë se një ditë do të mund ta shijojnë triumfin e fitores. Figurës së gruas **Helena Kadare** i kushton rol shumë të rëndësishëm. Ajo është një treguese e përgjithshme e vuajtjeve njerëzore. Në disa shkrime ajo del në një gjendje që nuk mund ta jetojë as rininë e saj. Në këtë mënyrë femra ka për qëllim të demaskojë mendimin prapanik viktimë e të cilit është vetë ajo. Dhembjen e këtyre femrave nuk e sheh askush, sepse çdonjëri mundohet t'i harrojë ato sa më shpejt. Sepse këto femra do t'u ngjallnin atyre përdëllim të cilin ata nuk ia dëshirojnë vetes. Si gjithë femrat e tjera edhe ata e duan jetën, prandaj durimi i tyre është i madh, ashtu si dashuria që ka për jetën. Ajo i bën ballë çdo gjëje dhe e duron edhe barrën që i rëndon mbi kurriz, vetëm që të ketë jetë të qetë dhe të gjejë lumturinë. Këto femra ndiejnë vetmi të madhe nga që hidhen në krahët e atyre që nuk i meritojnë.

- 74 -

Duke ua dhuruar shpirtin të tillëve, ato qëndrojnë të heshtura përballë një dhembjeje të madhe. Ata shpesh qeshin dhe shfaqen të lumtura, ndërkohë që zemra u qan. Figura e femrës është paraqitur me të gjitha virtytet e gruas së zakonshme. Ajo di ta tregojë karakterin e gruas besnike, e cila është *qenie* delikate, e ndjeshme dhe me plot ëndërra për *jetën*, është një heroinë dhembshurie. Në këtë rrugëtim të gjatë dhe të vështirë nuk mund të mos falenderoj, me një mirënjohje të madhe mentorin tim prof. dr. Hamit Xhaferi, si dhe Departamentin e gjuhës, kulturës dhe letërsisë shqipe, në Universitetin e Evropës Juglindore.

8. Bibliografia:

Aliu A., Vepra të zgjedhura III, Shkup, 2005

Kadare H. **"Një lindje e vështirë"**, Tiranë, 1970.

Kadare H., **Një grua nga Tirana**, Tiranë, 1990.

Kadare H., **"Bashkëshortët"**, Tiranë, 2002.

Kadare H., **"Kohë e pamjaftueshme"**, 2011

Kadare I., **Përballë pasqyrës së një gruaje, Onufri 2001**, Tiranë, 2001

Kadare I., **Unaza në kthetra, Onufri**, Tiranë, 2004

Xhaferi H. “**Shtjellime letrare**”, Semantika e dashurisë në romanin "Nata me hënë" të Ismail Kadaresë, Tetovë, 2018.

Xhaferi H. **Semantika e dashurisë në romanin "Nata me hënë"** të Ismail Kadaresë

- 76 -

Deklaratë

Deklaroj se punimi i magjistraturës „**Figura e femrës në veprat e Helena Kadaresë. Vepra letrare dhe epistoare e Musine Kokolarit**“ e kandidatës **Fitore Jahiji**, studente e nivelit të Masterit në Universitetin e Evropës Juglindore, i është nënshtruar lekturës gjuhësore profesionale nga ana jonë. Me këtë deklarojmë se punimi i magjistraturës i plotëson kriteret gjuhësore për të vazhduar tutje me mbrojtjen e temës së magjistraturës.

Lektori: Prof. Thimi Nesti



Tiranë: 24.03. 2020



ОБРАЗОВАНИЕ

ЗНАЕЊЕТО Е СИЛА, ЗНАЕЊЕТО Е МОЌ

Проверка на плагиати - Извешта

Извешта за: "FITORE JAHIJ -H.Kadare.pdf" Резултат за документот: **2.46% [380/15461 зборови]** Документот **FITORE JAHIJ - H.Kadare.pdf** содржи **15461** зборови од кои за **380 (2.46%)** е пронајдено совпаање во 169 документи. Овој извешта не е веродостоен на

датум **23.03.2020**, биде и некои од документите што се дел од извешта
от не се нао аат пове е во базата на податоци. Доколку сакате да
добие веродостоини информации за документот, повторно генерира те
нов извештај

Документи

Документ База на

Резултат

авна база на

0.15% [23/15461

датотеки зборови]

6.05% [23/380 зборови]

авна база на датотеки

0.13% [20/15461 датотеки

зборови]зборови]

5.26% [20/380 зборови]

Резултат

0.12% [18/15461 зборови] 4.74% [18/380 зборови]

0.12% [18/15461 зборови] 4.74% [18/380 зборови]

0.1% [16/15461 зборови] 4.21% [16/380 зборови]

Текст од документот ко што се проверува

FITORE JAHUJI -H.Kadare.pdf

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE УНИВЕРЗИТЕТ НА
УГОИСТОЧНАЕВРОПА

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI DYTË TEMA MASTER

Извешта от е генериран од: Hamit Xhaferi на: 23.03.2020 1

